FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 245

Tiranë – E hënë, 29 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 74/2025, datë 4.12.2025	Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje	31031
Dekret i Presidentit nr. 501, datë 23.12.2025	Për shpallje ligji	31041
Ligj nr. 75/2025, datë 4.12.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar	31041
Dekret i Presidentit nr. 502, datë 23.12.2025	Për shpallje ligji	31043
Ligj nr. 76/2025, datë 4.12.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 95/2015, "Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik", i ndryshuar	31043
Dekret i Presidentit nr. 503, datë 23.12.2025	Për shpallje ligji	31047
Ligj nr. 77/2025, datë 4.12.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 15/2015, "Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian", i ndryshuar	31047
Dekret i Presidentit nr. 504, datë 24.12.2025	Për shpallje ligji	31051
Ligj nr. 87/2025, datë 12.12.2025	Për buxhetin e vitit 2026	31051
Dekret i Presidentit nr. 505, datë 24.12.2025	Për shpallje ligji	31107

LIGJ
Nr. 74/2025

PËR PËRGJEGJËSITË E ZGJERUARA TË SUBJEKTEVE PRODHUESE TË PRODUKTEVE QË GJENEROJNË MBETJE[1]

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim krijimin e sistemit të përgjegjësive të zgjeruara të subjekteve prodhuese për produktet që gjenerojnë mbetje (në vijim "PZP") dhe të sigurojë që çdo person fizik ose juridik, që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit në funksion të rritjes së ripërdorimit, parandalimit, riciklimit dhe rikuperimeve të këtyre produkteve.

Neni 2
Objekti i ligjit

Ky ligj ka si objekt përcaktimin e:

a) masave të nevojshme, që ndërmerren nga subjekti prodhues për të mbajtur përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit;

b) rregullave për krijimin, *organizimin* e funksionimin e sistemit të përgjegjësive të zgjeruara të subjekteve prodhuese për produktet që gjenerojnë mbetje dhe të shoqërisë për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese (në vijim "SHPZP");

c) rregullave për krijimin dhe *administrimin* e regjistrit të prodhuesve PZP dhe SHPZP, që zbatojnë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Mbetje bashkiake" janë:

a) mbetje shtëpiake të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drurin, tekstilet, ambalazhet, pajisjet elektrike dhe elektronike, përfshirë të gjitha pjesët përbërëse të tyre individuale apo të bashkuara dhe materialet e konsumit, që janë pjesë përbërëse e këtyre pajisjeve, mbetjet e baterive, mbetjet e vëllimshme, duke përfshirë mobiliet, dyshekët dhe të ngjashme;

b) mbetje të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar nga burime të tjera, kur këto mbetje kanë natyrë dhe përbërje të ngjashme me mbetjet shtëpiake.

Mbetjet bashkiake nuk përfshijnë mbetjet nga prodhimi, bujqësia, pyjet, peshkimi, gropat septike, rrjetin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, sistemin e kullimit, si dhe llumrat e ujërave të ndotura, automjetet në fund të jetës, mbetjet nga ndërtimi.

2. "Përdorues i fundit" është çdo person fizik ose juridik, që përdor produktin për konsum final.

3. "Subjekt prodhues" është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar, i cili mbi baza profesionale zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit.

4. "Subjekt prodhues i kontraktuar" është prodhuesi i produkteve, pjesë e sistemit PZP, detyrimet e të cilit për PZP-në janë marrë përsipër nga SHPZP-ja *nëpërmjet një kontrate të nënshkruar dhe të regjistruar.*

5. "Produkt PZP" është produkti, pjesë e sistemit PZP, *që pas konsumit krijon mbetje dhe për të cilin aplikohet përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit sipas përcaktimeve të këtij ligji.*

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22.11.2008, faqe 3–30.

6. "Rryma specifike e mbetjeve" nënkupton të gjitha rrymat e mbetjeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

7. "Sistemi i PZP-së" është tërësia e rregullave, që kanë qëllim të sigurojnë që subjekti prodhues, i cili hedh në treg produkte, pjesë e regjimit të rrymave specifike të mbetjeve, të mbajë përgjegjësi financiare dhe organizative për të menaxhuar stadin e mbetjeve në ciklin e jetës së produktit.

8. "Shoqëri për përgjegjësinë e zgjeruar të subjektit prodhues" është personi juridik i organizuar në formën e shoqërisë tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare *që përmbush detyrimet e PZP-së për subjekte prodhuese.*

9. "Vendosje në treg" është furnizimi ose vënia në dispozicion për qarkullim për herë të parë në tregun shqiptar të produktit, pjesë e sistemit të PZP-së.

Neni 4
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

1. Të gjitha subjektet prodhuese, që ushtrojnë në Republikën e Shqipërisë aktivitete ekonomike, të cilat lidhen me qëllimin e këtij ligji, nën sistemin e PZP-së dhe hedhin për herë të parë në treg produkte, që pas përdorimit të tyre krijojnë mbetje në përputhje me legjislacionin në fuqi për rrymat specifike të mbetjeve.

2. Të paktën rrymat specifike të mbetjeve të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve si më poshtë:

a) ambalazhet e mbetjet e tyre;

b) bateritë dhe akumulatorët;

c) automjetet në fund të jetës;

ç) mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike;

d) vajrat e përdorura.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në ushtrim të funksioneve të tyre, me qëllim arritjen e objektivave kombëtarë në fushën e mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe atë për vetëqeverisjen vendore.

KREU II
SISTEMI I PËRGJEGJËSIVE TË ZGJERUARA TË SUBJEKTEVE PRODHUESE

Neni 5
Detyrimet e subjekteve prodhuese

1. Çdo subjekt prodhues, që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale produkte që gjenerojnë mbetje, pas përdorimit përfshihet në sistemin e përgjegjësisë së zgjeruar të subjekteve prodhuese.

2. Subjekti prodhues ka këto detyrime:

a) regjistrohet si subjekt i PZP-së në regjistrin përkatës, që administron Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

b) krijon dhe mban regjistrin për sasitë e produkteve të prodhuara ose të importuara, të vendosura në treg;

c) raporton për produktet e vendosura në treg në sasi dhe peshë sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ç) pranon pa pagesë produktet e kthyera dhe mbetjet e krijuara pas përdorimit të tyre;

d) menaxhon mbetjet e produkteve të vendosura në treg të parashikuara në shkronjën "c" të kësaj pike dhe merr/mbart përgjegjësi financiare për këto veprimtari;

dh) zbaton detyrimet e sistemit PZP, veçanërisht lidhur me pagesën e kontributeve financiare dhe mbledhjen e të dhënave për produktet e vendosura në treg, nëse vendosja e sistemit PZP parashikohet në përputhje me nenin 6 të këtij ligji;

e) informon konsumatorët për mënyrën e ripërdorimit, dorëzimit, sistemet e ngritura, pikat më të afërta të grumbullimit, ndikimet në mjedis dhe shëndet, në përputhje me parashikimet e nenit 7 të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve.

3. Subjekti prodhues paraqet çdo vit një vetëdeklarim për vërtetimin e përmbushjes së detyrimeve për vitin paraardhës pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin së bashku me bilancin vjetor. Vetëdeklarimi përmban, ndër të tjera, edhe të dhënat për sasitë e kthyera të mbetjeve dhe për çdo lloj e kategori të tyre, për një vit të caktuar, si dhe të dhënat për dorëzimin e tyre ricikluesve ose trajtuesve të licencuar, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

4. Subjekti, prodhuesi i kontraktuar, nëpërmjet SHPZP-së paraqet në ministri një raport vjetor për

sasinë e produkteve PZP të hedhura në tregun vendas, përfshirë të dhënat për sasitë e kthyera të mbetjeve, si dhe për çdo lloj e kategori të tyre për një vit të caktuar, si dhe të dhënat për dorëzimin e tyre ricikluesve ose trajtuesve të licencuar brenda datës 30 prill të vitit pasardhës financiar.

5. Rregullat për mbajtjen, paraqitjen dhe formatin e vetëdeklarimit të subjektit prodhues dhe raportit vjetor të SHPZP-së për subjektin prodhues të kontraktuar, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

6. Subjekti prodhues kontribuon për përmbushjen e objektivave kombëtarë për mbetjet e gjeneruara nga produktet që ka vendosur për herë të parë në treg, në masën e përcaktuar në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe në Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

7. Duke filluar nga data 1 dhjetor 2026 minimumi i objektivave kombëtarë, që duhen përmbushur nga çdo subjekt prodhues për vitin ekzistues, është i barabartë me pjesën që ka prodhuesi në sasitë totale të produkteve PZP të vendosura në treg në vitin paraardhës, të cilat i përkasin të njëjtës kategori mbetjesh për të cilën është subjekt i PZP-ve.

Neni 6

Sistemi për përgjegjësinë e zgjeruar të subjekteve prodhuese

1. Subjekti prodhues që vendos për herë të parë në treg produkte PZP, objekt i këtij ligji, krijon sistemin e përgjegjësisë së zgjeruar të subjekteve prodhuese.

2. Përveç detyrimeve të parashikuara në nenin 5 të këtij ligji, subjekti prodhues siguron:

a) grumbullimin e mbetjeve, që dalin nga këto produkte si mbetje bashkiake;

b) trajtimin e mbetjeve të grumbulluara nga produktet sipas pikës 1 të këtij neni;

c) përmbushjen e objektivave të grumbullimit të veçantë, përgatitjes për ripërdorim, riciklimit ose procedurave të tjera të rikuperimit të mbetjeve, që dalin nga produktet sipas pikës 1 të këtij neni;

ç) përmbushjen e objektivave kombëtarë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Minimumi i objektivave kombëtarë, që duhen përmbushur për vitin ekzistues, është i barabartë me pjesën që ka subjekti prodhues në sasitë totale të produkteve PZP të vendosura në treg në vitin paraardhës, sipas rrymave përkatëse të mbetjeve.

3. Subjektet prodhuese zbatojnë detyrimet e tyre sipas mënyrave të mëposhtme:

a) organizojnë vetë sistemin e marrjes mbrapsht, të grumbullimit e të trajtimit të mbetjeve;

b) së bashku me subjektet prodhuese të tjera organizojnë një sistem kolektiv të organizuar të marrjes mbrapsht, grumbullimit e trajtimit të mbetjeve nëpërmjet një subjekti të licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie; ose

c) krijojnë SHPZP për marrjen mbrapsht, grumbullimin e trajtimin e mbetjeve në përputhje me këtë ligj.

4. Subjektet prodhuese, të parashikuara në shkronjën "b" të pikës 3 të këtij neni, përgjigjen financiarisht dhe nga ana organizative për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë pikë sipas pjesës takuese përkatëse, të përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet tyre, si dhe me subjektin e licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

5. Subjektet prodhuese, të parashikuara në shkronjën "c" të pikës 3 të këtij neni, përgjigjen financiarisht dhe nga ana organizative për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë pikë sipas pjesës takuese përkatëse, të përcaktuar në kontratat e lidhura ndërmjet tyre dhe parashikimeve të këtij ligji.

6. Kontributi financiar, në zbatim të pikave 4 dhe 5 të këtij neni, përfshin:

a) kthimin e të gjitha produkteve të përdorura dhe të mbetjeve të gjeneruara prej tyre;

b) grumbullimin e diferencuar, magazinimin e përkohshëm të mbetjeve të paktën për sasinë minimale të objektivit të grumbullimit të përcaktuar, sipas parashikimeve të këtij ligji;

c) transportin, rikuperimin, ripërdorimin ose riciklimin e rrymave specifike të mbetjeve të paktën për sasinë minimale të objektivit të trajtimit të përcaktuar, sipas parashikimeve të nenit 10 të këtij ligji;

ç) zhvillimin e aktiviteteve të përshtatshme të informimit, ndërgjegjësimit, udhëzimit ose trajnimit për t'u ofruar qytetarëve informacion për ushtrimin e të drejtave të tyre si konsumatorë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

d) investimet në infrastrukturën e grumbullimit, me qëllim që të përballojë përzgjedhjen e çdo lloj produkti PZP dhe/ose rrymat specifike të mbetjeve

ose kategorinë për të cilin prodhuesi ka detyrime, që lindin nga sistemi i PZP-së;

dh) kostot administrative për përmbushjen e detyrimeve të vendosura në zbatim të këtij neni.

7. Kontributi financiar i përcaktuar në pikën 5 të këtij neni nuk tejkalon kostot e kërkuara për ofrimin e shërbimeve në këtë pikë.

Neni 7
Detyrimi për informim

1. Subjekti prodhues, vetë apo nëpërmjet SHPZP-së, informon konsumatorët për:

a) mënyrat e ripërdorimit të produktit si të plotë ose për pjesët përbërëse të tij, mënyrat e çmontimit të produktit, si dhe të trajtimit të mbetjeve të gjeneruara pas përdorimit;

b) dorëzimin e produkteve që gjenerojnë mbetje në pika të afërta grumbullimi lehtësisht të aksesueshme prej tyre e të sugjeruara nga prodhuesi;

c) sistemet e ngritura për marrjen mbrapsht dhe grumbullimin e mbetjeve deri në asgjësim;

ç) vendin më të afërt për të dorëzuar mbetjet në rast refuzimi për të kthyer mbetjet;

d) ndikimin që kanë mbetjet e gjeneruara në mjedis dhe shëndetin e njeriut.

2. Informacioni jepet në mënyrë të qartë në etiketën e produktit ose/dhe në faqen zyrtare të SHPZP-së. Formati i etiketës dhe modalitetet e gjurmueshmërisë së produktit në të gjithë ciklin e tij në treg përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës.

3. Subjekti prodhues, vetë apo nëpërmjet SHPZP-së, informon tregtarët për mënyrën e kthimit të produkteve të përdorura ose të mbetjeve të krijuara nga konsumatorët, duke përfshirë edhe tregtarin e fundit, që shet dhe/ose i dorëzon produktet konsumatorit.

Neni 8
Detyrimi për regjistrim dhe kontrata me shoqërinë për përgjegjësinë e zgjeruar të subjektit prodhues

1. Çdo subjekt prodhues, në cilësinë e zotëruesit të rrymës specifike të mbetjeve, në rast se nuk e organizon vetë sistemin e marrjes mbrapsht, të grumbullimit e të trajtimit të mbetjeve, regjistrohet në SHPZP sipas rrymës përkatëse për të cilën është subjekt i detyrimeve të PZP-së.

2. Subjekti prodhues, subjekt i PZP-së, nënshkruan një kontratë me SHPZP-në për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga sistemi i PZP-së, sipas parashikimeve të shkronjave "b" dhe "c" të pikës 3 të nenit 6 të këtij ligji për të paktën një vit fiskal.

3. Subjekti prodhues lidh kontratë të veçantë vetëm me një SHPZP për çdo rrymë mbetjeje të caktuar dhe në kontratë, përveç të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet palëve, parashikohen shprehimisht rastet kur SHPZP-ja nuk arrin të përmbushë detyrimet e subjektit prodhues për PZP-në dhe objektivat e lidhur me to, si dhe/ose është në pamundësi financiare për të paguar penalitetet për mospërmbushjen e detyrimeve. Në çdo rast, detyrimet paguhen në përputhje me përqindjen e produkteve të vendosura në tregun vendas për vitin në të cilin objektivi nuk është përmbushur.

Neni 9
Detyrimi për raportim pranë shoqërisë për përgjegjësinë e zgjeruar të subjektit prodhues

1. Subjekti prodhues i kontraktuar i paraqet SHPZP-së një raport tremujor për sasinë e produkteve PZP të vendosura në treg brenda datës 15 të muajit pasardhës. Ky afat zbatohet edhe në rastin kur prodhuesi nuk ka hedhur në treg asnjë produkt për atë periudhë trimujore.

2. Raportet trimujore për sasinë totale të produkteve të vendosura në treg gjatë një tremujori nga të gjitha subjektet prodhuese të kontraktuara nga SHPZP-ja i dërgohen AKM-së nga SHPZP-ja jo më vonë se dita e fundit e muajit pasardhës të atij tremujori.

KREU III
PËRGJEGJËSITË E SHOQËRISË PËR PËRGJEGJËSINË E ZGJERUAR TË SUBJEKTIT PRODHUES

Neni 10
Detyrimet e shoqërisë për përgjegjësinë e zgjeruar të subjektit prodhues

1. SHPZP-ja merr përsipër detyrimet PZP të subjekteve prodhuese për një rrymë të caktuar mbetjesh, për sasitë e produkteve PZP të hedhura në treg për çdo vit të ushtrimit të veprimtarisë.

2. SHPZP-ja ka detyrimin të pajiset me autorizim në zbatim të nenit 11 të këtij ligji për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

3. SHPZP-ja nënshkruan një kontratë me subjektin prodhues të kontraktuar, që përcakton detyrimet kryesore që përmbush secila palë sipas kërkesave të këtij ligji dhe përmban parashikime për sasitë e planifikuara për çdo rrymë e çdo lloj mbetjesh, si dhe mënyrën e raportimit dhe të mbikëqyrjes së zbatimit.

4. SHPZP-ja nënshkruan me subjekte të licencuara për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve sipas përcaktimeve të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

5. SHPZP-ja njofton subjektet prodhuese të kontraktuara për veprimtaritë lidhur me mbledhjen e trajtimin e mbetjeve gjatë vitit paraardhës, duke specifikuar përmbushjen e objektivave minimalë dhe pjesën e tregut që mbulon secili produkt PZP brenda datës 30 prill të vitit pasardhës.

6. SHPZP-ja mbledh dhe raporton të dhëna pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, sipas parashikimeve të këtij ligji, nëpërmjet të cilave vërtetohet qartë se detyrimet PZP janë përmbushur për secilin subjekt prodhues dhe për rrymat e veçanta të mbetjeve.

Neni 11

Autorizimi i shoqërisë për përgjegjësinë e zgjeruar të subjektit prodhues

1. Për pajisjen me autorizim, SHPZP-ja plotëson kriteret e mëposhtme:

a) regjistrohet pranë QKB-së si shoqëri tregtare, me objekt veprimtarie menaxhimin e mbetjeve dhe përgjegjësitë e zgjeruara të subjektit prodhues;

b) vërteton dakordësinë e përfaqësimit të subjekteve prodhuese për secilën rrymë mbetjesh, objekt i këtij ligji;

c) paguan tarifën për pajisjen me autorizim.

2. SHPZP-ja, para fillimit të çdo aktiviteti për përmbushjen e detyrimeve PZP, aplikon në portalin unik qeveritar "e-Albania" për pajisjen me autorizim vetëm për një rrymë mbetjesh sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

3. SHPZP-ja pajiset me autorizim nga ministria përgjegjëse për mjedisin sipas modelit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin për ushtrimin e veprimtarisë për një rrymë specifike, në përputhje me parimet e procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

4. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 5-vjeçare.

5. Në rast mospërmbushjesh të detyrimeve të SHPZP-së ndaj subjekteve prodhuese, SHPZP-së i pezullohet ose i anulohet autorizimi përkatës nga ministria sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

6. Dokumentacioni për pajisjen me autorizim, procedurat e shqyrtimit të aplikimit, afatet dhe tarifa për pajisjen me autorizim për SHPZP-në miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 12

Zgjidhja e kontratës së shoqërisë për përgjegjësinë e zgjeruar të subjektit prodhues me subjektin prodhues

1. Në rast se SHPZP-ja nuk përmbush objektivat minimalë për mbledhjen e trajtimin e një rryme specifike mbetjeje me më shumë se 10 (dhjetë) për qind nën kufirin e detyrueshëm, SHPZP-ja paguan një gjobë të barabartë me dyfishin e vlerës së kontributit financiar përkatës.

2. SHPZP-ja zgjidh kontratën me subjektin prodhues në rast se ky i fundit nuk paguan kontributin financiar përkatës të autorizimit për dy periudha të njëpasnjëshme pagesash.

3. SHPZP-ja, e cila zgjidh kontratën sipas pikës 1 të këtij neni, shkarkohet nga detyrimi për mbledhjen e trajtimin e mbetjeve në përpjesëtim me sasinë për të cilën prodhuesi nuk ka paguar kontributin financiar takues.

4. Nëse subjekti prodhues e ka paguar kontributin financiar takues te SHPZP-ja, së cilës i hiqet autorizimi, ky subjekt prodhues nuk paguan detyrime të tjera financiare për këtë pjesë të vitit për të cilën ka paguar.

5. AKM-ja njofton strukturat inspektuese për mospërmbushjen e objektivave nga SHPZP-ja dhe prodhuesit e kontraktuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e konstatimit të mospërmbushjes së tyre. Struktura inspektuese kompetente merr masa për vendosjen e gjobës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit.

Neni 13
Kontributi financiar për shoqërinë për përgjegjësinë e zgjeruar të subjektit prodhues

1. SHPZP-ja njofton me shkrim ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe AKM-në për përmbushjen e detyrimeve financiare nga ana e subjekteve prodhuese për çdo rrymë dhe lloj mbetjeje, si dhe kushtet e përgjithshme të kontratës me secilin prej tyre brenda datës 15 nëntor të çdo viti, duke nisur nga viti i themelimit të SHPZP-së.

2. Subjekti prodhues i paguan SHPZP-së kontributin financiar çdo tre muaj, sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet tyre, për sasinë e produkteve dhe të rrymave specifike të mbetjeve, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji.

3. Kontributi financiar, që subjekti prodhues ka detyrimin t'i paguajë SHPZP-së, nuk duhet të jetë më pak se 50 (pesëdhjetë) për qind e kontributit financiar për atë produkt, subjekt i PZP-së.

4. SHPZP-ja bën publike të dhënat për kontributin financiar të autorizimit dhe kontratat e nënshkruara me subjektin prodhues, lehtësisht të aksesueshme dhe transparente.

5. Kontributi financiar i paguar nga subjekti prodhues te SHPZP-ja mbulon kostot për përmbushjen e detyrimeve të tyre PZP si më poshtë:

a) kostot për grumbullimin dhe trajtimin për çdo lloj mbetjeje, përfshirë kostot e eliminimit të tepricave të mbetjeve, nëse ka;

b) kostot operative për veprimtarinë e SHPZP-së;

c) kostot për komunikimin me publikun dhe aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit;

ç) kostot për investimet në infrastrukturën e mbledhjes së mbetjeve në mënyrë që të mundësohet përzgjedhja e rrymave specifike dhe llojeve të mbetjeve për të cilat është autorizuar SHPZP-ja.

Neni 14
Detyrimi për informim i shoqërisë për përgjegjësinë e zgjeruar të subjektit prodhues

1. SHPZP-ja shpenzon një shumë në masën nga 10 (dhjetë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) për qind të të ardhurave totale të vitit paraardhës për aktivitete nxitëse dhe promovuese, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit te konsumatorët për zbatimin e këtij ligji dhe për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve, si dhe ndarjen në burim e trajtimin e tyre.

2. Përjashtimisht për 3 (tre) vjetët e parë të autorizimit, SHPZP-ja shpenzon deri në 20 (njëzet) për qind të të ardhurave totale të vitit paraardhës për aktivitetet e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. SHPZP-ja bashkëpunon me SHPZP të tjera, subjektet prodhuese, tregtarë, persona të tjerë juridikë, institucione shtetërore e private, si dhe me ministrinë për të zhvilluar aktivitete të përshtatshme informimi, ndërgjegjësimi, udhëzimi ose trajnimi për të informuar qytetarët në ushtrimin e të drejtave të tyre si konsumatorë.

Neni 15
Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. SHPZP-ja dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet lidhjes së një kontrate bashkëpunojnë dhe financojnë së bashku infrastrukturën për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, duke garantuar që përdoruesit e fundit t'i dorëzojnë mbetjet pa pagesë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe për vetëqeverisjen vendore.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore bashkëpunon me SHPZP-në në mënyrë që kjo e fundit të ofrojë shërbimet e veta në territorin, që ka nën juridiksion njësia e vetëqeverisjes vendore, dhe të organizojë e të zbatojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

3. SHPZP-ja dhe njësia e vetëqeverisjes vendore lidhin një kontratë me shkrim për mënyrën e bashkëpunimit në të cilën mund të përcaktohet që ngritja dhe funksionimi i skemës së PZP-së të kryhet vetëm nga SHPZP-ja për atë rrymë mbetjesh që ka autorizim apo vetëm nga njësia e vetëqeverisjes vendore ose të dyja së bashku.

4. Kontrata që lidhet sipas pikës 3 të këtij neni mbulon detyrimet kryesore të secilës palë, sipas kërkesave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Kontrata përmban të paktën elementet e mëposhtme:

a) kërkesat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, duke përfshirë rrymën specifike të mbetjeve, numrin e popullsisë për zonën ku ofrohet shërbimi, vendndodhjen e mbetjeve, si dhe periodicitetin e ofrimit të shërbimit;

b) objektivat për grumbullimin e diferencuar, riciklimin dhe rikuperimet e tjera të mbetjeve, si dhe mënyrën e raportimit për përmbushjen e këtyre objektivave;

c) kushtet dhe afatet për monitorimin e zbatimit të kërkesave të këtij ligji në territorin që ka nën juridiksion njësia e vetëqeverisjes vendore;

ç) kushtet për zhvillimin e aktiviteteve të përshtatshme: informimi, ndërgjegjësimi, udhëzimi ose trajnimi për të informuar qytetarët në territorin që ka nën juridiksion njësia e vetëqeverisjes vendore;

d) kushtet për bashkëfinancimin e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

5. Formati i kontratës tip ndërmjet SHPZP-së dhe njësive të vetëqeverisjes vendore miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore dhe të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

KREU IV
INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

Neni 16
Institucionet përgjegjëse

1. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë:

a) ministria përgjegjëse për mjedisin;

b) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

c) struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit;

ç) struktura përgjegjëse për inspektimin për mbikëqyrjen e tregut;

d) institucioni përgjegjës për doganat;

dh) institucioni përgjegjës për tatimet;

e) njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Institucionet përgjegjëse ushtrojnë detyrat sipas legjislacionit përkatës dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre.

Neni 17
Ministria përgjegjëse për mjedisin

Ministria përgjegjëse për mjedisin është institucioni përgjegjës për:

a) mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

b) koordinimin ndërinstitucional lidhur me zbatimin e mirëfunksionimin e sistemit PZP;

c) pajisjen me autorizim për SHPZP-në për ushtrimin e veprimtarive lidhur me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të krijuara nga produktet dhe rrymave specifike të mbetjeve për rikuperimin, ripërdorimin ose riciklimin e tyre;

ç) përgatitjen dhe propozimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji;

d) informimin e publikut të gjerë në lidhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për zbatimin e sistemit PZP, kur konsiderohet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose mjedisit.

Neni 18
Institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin

Institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e sistemit të përgjegjësive të zgjeruara të subjekteve prodhuese janë:

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim AKM), si institucioni përgjegjës i kontrollit në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhur me produktet PZP për:

a) krijimin, funksionimin dhe administrimin e regjistrit të produkteve PZP për prodhuesit PZP dhe SHPZP, sipas përcaktimeve të nenit 19 të këtij ligji;

b) verifikimin e të dhënave dhe kontrollin e tregtarit, të subjekteve prodhuese PZP dhe SHPZP në lidhje me informacionin e përfshirë në raportimet përkatëse pranë Agjencisë, sipas parashikimeve të këtij ligji;

c) monitorimin e strukturave dhe hapësirave, ku prodhohen, ruhen, përdoren ose shiten produktet PZP;

ç) kryerjen e kontrollit të tërheqjes së produkteve në rast se nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji;

d) kur i kërkohet, asistimin e institucioneve përgjegjëse për identifikimin e produkteve PZP.

2. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit, e cila inspekton subjektet prodhuese për zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe vendosjen e masave administrative përkatëse;

3. Struktura përgjegjëse për inspektimin për mbikëqyrjen e tregut, që kryen këto veprime:

a) ushtron kontrolle të përshtatshme për karakteristikat e produkteve PZP, përfshirë dhe pikat e shitjes së produkteve PZP, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore;

b) organizon në bashkëpunim me operatorët ekonomikë kthimin/tërheqjen nga tregu të produkteve PZP, në rast se nuk plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi;

c) siguron marrjen e masave për ndalimin e tregtimit ose ndalimin apo kufizimin e bërjes së disponueshme të produkteve PZP në treg, kur nuk plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi.

4. Autoriteti doganor është përgjegjës për kontrollin e produkteve, pjesë e sistemit të PZP-së në pikat doganore të hyrjes e të daljes.

5. Kontrollet e përcaktuara në këtë nen kryhen sipas parimeve, procedurave dhe në mënyrën e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për inspektimin, legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit, atë doganor dhe atë për mbikëqyrjen e tregut.

KREU V
REGJISTRIMI DHE RAPORTIMI

Neni 19
Regjistri i sistemit për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Agjencia Kombëtare e Mjedisit administron bazën e të dhënave shtetërore të Sistemit të Informacionit të Integruar Mjedisor, pjesë e të cilave janë edhe të dhënat për subjektet prodhuese për çdo produkt PZP dhe të SHPZP-ve.

2. Subjektet prodhuese PZP dhe SHPZP-të raportojnë pranë Agjencisë çdo ndryshim të të dhënave.

3. Struktura përgjegjëse në AKM verifikon të paktën çdo 5 (pesë) vjet të dhënat e prodhuesve PZP dhe SHPZP-ve.

4. AKM-ja publikon e përditëson çdo vit regjistrin me të dhënat për sasinë totale të produkteve PZP, sipas llojit dhe rrymave të mbetjeve të krijuara.

5. Rregullat e detajuara në zbatim të pikës 1 të këtij neni, të dhënat parësore dhe dytësore, si dhe niveli i aksesueshmërisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 20
Procedura për regjistrimin e subjekteve prodhuese

1. Subjekti prodhues aplikon për regjistrim në portalin unik qeveritar "e-Albania" dhe pajiset nga AKM-ja me certifikatën e regjistrimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga dita e aplikimit.

2. Rregullat për procedurën e regjistrimit dhe të çregjistrimit, afatet, dokumentacioni, mbajtja e të dhënave dhe përditësimi i tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 21
Raportimi vjetor

1. Subjektet prodhuese PZP dhe SHPZP raportojnë në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe AKM çdo 6 (gjashtë) muaj, në dy vitet e para të regjistrimit dhe të autorizimit të tij dhe pas këtij afati raportimi bëhet një herë në vit sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.

2. Subjektet prodhuese PZP dhe SHPZP paraqesin brenda datës 30 prill të çdo viti në strukturën përgjegjëse për mbetjet në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe në AKM raportin vjetor për produktet PZP të hedhura në treg, të audituara nga audituesi i licencuar.

3. Raporti përmban të dhëna për sasinë totale të produkteve PZP të vendosura në treg, sasitë e mbledhura dhe të trajtuara sipas produktit PZP dhe rrymave specifike të mbetjeve, si dhe përmbushjen e objektivave kombëtarë të mbetjeve.

4. Formati dhe mënyra e përgatitjes dhe e dorëzimit të raportit vjetor përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

5. Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe AKM-ja marrin masat e nevojshme për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të dorëzuar sipas këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU VI
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, MASAT DHE EKZEKUTIMI

Neni 22
Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë sipas kufijve dhe përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin.

2. Dënohen me gjobë shkeljet e mëposhtme:

a) mospërmbushja e detyrimit për regjistrim të subjektit prodhues në regjistrin që administron AKM-ja, mosmbajtja e regjistrit të produkteve dhe raportimi për sasinë e produkteve të prodhuara ose të importuara, sipas parashikimeve të shkronjave "a", "b" dhe "c" të pikës 2 të nenit 5 të këtij ligji, nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë;

b) mospërmbushja e detyrimit të subjektit prodhues të produkteve PZP lidhur me pagesën e kontributit financiar të sistemit PZP, sipas parashikimeve të shkronjës "dh" të pikës 2 të nenit 5 të këtij ligji, nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

c) mospërmbushja e detyrimeve për informimin e konsumatorëve nga subjekti prodhues, sipas parashikimeve të shkronjës "e" të pikës 2 të nenit 5 dhe të nenit 7 të këtij ligji, nga 100 000 lekë deri në 200 000 lekë;

ç) mosparaqitja e vetëdeklarimit për vërtetimin e përmbushjes së detyrimeve, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji, nga 100 000 lekë deri në 200 000 lekë;

d) mospërmbushja e detyrimit nga subjekti prodhues lidhur me regjistrimin dhe kontratat me SHPZP, sipas parashikimeve të nenit 8 të këtij ligji, nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

dh) mospajisja me autorizim e SHPZP-së, në zbatim të parashikimeve të këtij ligji, nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

e) mospërmbushja e detyrimit për raportimin periodik dhe vjetor nga ana e subjekteve prodhuese PZP dhe SHPZP dënohet me gjobë përkatësisht 200 000 lekë për subjektin prodhues dhe 500 000 lekë për SHPZP-në;

ë) mospërmbushja e detyrimit nga SHPZP-ja në përputhje me pikën 1 të nenit 12 të këtij ligji nga 200 000 lekë deri në 500 000 lekë;

f) dhënia e informacionit të pasaktë nga ana e subjektit prodhues PZP dhe SHPZP nga 100 000 deri në 200 000 lekë;

g) hedhja në treg dhe tregtimi i produkteve, që nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

gj) mospërmbushja e detyrimeve për informimin e konsumatorëve nga SHPZP-ja sipas parashikimeve të nenit 14 të këtij ligji nga 200 000 lekë deri në 300 000 lekë;

h) mospajisja me certifikatë regjistrimi e subjektit prodhues sipas parashikimeve të nenit 20 të këtij ligji nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë;

i) mospërmbushja e minimumit të objektivave kombëtarë nga SHPZP-ja për mbledhjen dhe trajtimin e një rryme specifike mbetjeje me më shumë se 10 (dhjetë) për qind, të barabartë me dyfishin e vlerës së kontributit financiar.

3. Gjoba e vendosur në zbatim të këtij ligji përbën titull ekzekutiv pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative. Gjoba paguhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data kur është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë që përbën titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e saj ngarkohet zyra e përmbarimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.

4. Të ardhurat e mbledhura nga gjobat derdhen 100 (njëqind) për qind në buxhetin e shtetit.

Neni 23

Procedura e kundërvajtjeve administrative

1. Kontrolli i zbatimit të këtij ligji dhe i akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe vendosja e gjobës dhe/apo pezullimi ose ndërprerja e veprimtarisë, sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin, kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit dhe struktura përgjegjëse inspektuese për mbikëqyrjen e tregut sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.

2. Konstatimi i shkeljeve që përbëjnë kundërvajtjeve administrative të parashikuara në nenin 22 të këtij ligji dhe vendosja e gjobës bëhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin në mjedis dhe struktura përgjegjëse inspektuese për mbikëqyrjen e tregut sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.

3. Kundër vendimit të masës administrative të vendosur nga struktura përgjegjëse inspektuese për mbikëqyrjen e tregut bëhet ankim në përputhje me legjislacionin e posaçëm në fuqi për inspektimin e mbikëqyrjes së tregut.

4. Kundër vendimit të masës administrative të vendosur nga struktura përgjegjëse për inspektimin në mjedis bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin dhe shqyrtimi e marrja e vendimit përfundimtar, ekzekutimi dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, si dhe me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

Neni 24
Pezullimi dhe anulimi i autorizimit

1. Pavarësisht nga dënimet e parashikuara në shkronjat "a" deri në "dh" të pikës 2 të nenit 22 të këtij ligji, Agjencia Kombëtare e Mjedisit i propozon ministrit përgjegjës për mjedisin:

a) pezullimin e autorizimit për SHPZP-në në rastet kur:

i. paraqitet kërkesë nga SHPZP-ja;

ii. SHPZP-ja nuk përmbush kushtet e parashikuara në autorizim dhe në kërkesat e këtij ligji;

b) anulimin e autorizimit të SHPZP-së në rastet kur:

i. paraqitet kërkesë nga SHPZP-ja;

ii. SHPZP-ja ka shkelur në mënyrë të përsëritur dispozitat e këtij ligji, gjë që ka çuar në vënien e gjobave administrative, në përputhje me nenin 22 të këtij ligji;

iii. SHPZP-ja nuk ka zbatuar brenda afatit të pezullimit detyrimet e përcaktuara si shkaqe të pezullimit;

iv. SHPZP-ja nuk ka paguar gjobat administrative të vëna sipas këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për mjedisin nxjerr urdhrin e pezullimit të autorizimit, duke i lënë subjektit një afat prej 20 (njëzet) ditësh për ripërmbushjen e shkaqeve të pezullimit.

3. Subjekti ndaj të cilit vendoset urdhri i pezullimit ka të drejtën e ankimit administrativ te titullari i strukturës përgjegjëse për mjedisin, sipas legjislacionit në fuqi për procedurat administrative.

4. Në rast se subjekti plotëson detyrimet për shkaqet e pezullimit, ministri shfuqizon urdhrin e pezullimit.

5. Në rast se subjekti nuk përmbush brenda afatit të pezullimit detyrimet e përcaktuara në shkaqet e pezullimit, ministri nxjerr urdhrin e anulimit të autorizimit përkatës.

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit publikon aktin e pezullimit apo të anulimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

7. SHPZP-ja, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit administrativ, sipas afateve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi.

8. Kundër vendimit përfundimtar të ministrit, SHPZP-ja ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente për çështje administrative në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU VII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 2 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 2; 11, pika 6; 15, pika 5; 19, pika 5, dhe 20, pika 2, të tij.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për mjedisin që brenda 2 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 5, 11, pika 3 dhe 21, pika 4, të tij.

Neni 26
Dispozita kalimtare

1. Subjektet prodhuese, të cilat në bazë të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, kanë detyrimin e pagesës së taksës për materiale/artikuj plastikë dhe të taksës së ambalazheve prej plastike/qelqi, përjashtohen nga detyrimi i pagesës së kontributit financiar, sipas këtij ligji *për të njëjtat produkte, për periudhën kur mbetet në fuqi detyrimi tatimor përkatës sipas ligjit të mësipërm.*

2. Kërkesat dhe proceduarat administrative për shërbimet që preken nga ky ligj zbatohen në momentin që përfundojnë zhvillimet teknike për pritjen e aplikimeve në Sistemin e Informacionit të Integruar Mjedisor.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 dhjetor 2026.

Miratuar në datën 4.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 501, datë 23.12.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 501, datë 23.12.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 74/2025, "Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 75/2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 304, DATË 15.7.2010, "PËR SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj fjala "karrierë" zëvendësohet me fjalët "minierë sipërfaqësore".

Neni 2

Pika 4 e nenit 2 ndryshohet si më poshtë:

"4. "Mineral" është çdo substancë e dobishme, që ndodhet në trajtë natyrore, mbi ose nën sipërfaqen e tokës, në ujë ose nën ujë, e formuar prej proceseve gjeologjike dhe që plotëson kushtet për përdorim në degë të ndryshme të ekonomisë, duke përjashtuar naftën, që është në gjendje të lëngët, gazin natyror, që është në gjendje të gaztë dhe ujërat.".

Neni 3

Shkronja "a" e pikës 3 të nenit 9 shfuqizohet.

Neni 4

Fjalia e dytë e pikës 5 të nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

"Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj aplikon pranë ministrisë përgjegjëse për pyjet për heqjen nga fondi pyjor/kullosor të zonës së lejuar të shfrytëzimit, të miratuar sipas legjislacionit në fuqi për pyjet dhe kullotat.".

Neni 5

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2 fjala "pushimit" zëvendësohet me fjalën "ndërprerjes".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Njoftimi i pezullimit, sipas shkronjës "dh" të pikës 1 të këtij neni miratohet nga ministri për një afat jo më të gjatë se 2 (dy) vjet.

Në tri vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë minerare, zotëruesi i lejes minerare nuk mund të paraqesë kërkesë për pezullim të përkohshëm.

Procedurat dhe rregullat për shkaqet dhe mënyrën e njoftimit për pezullim nga ana e zotëruesit të lejes miratohen nga ministri në bashkërendim me strukturat përgjegjëse për veprimtarinë minerare.".

Neni 6

Fjalia e dytë e pikës 10 të nenit 24 ndryshohet si më poshtë:

"Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj aplikon pranë ministrisë përgjegjëse për pyjet për heqjen nga fondi pyjor/kullosor të zonës së lejuar të shfrytëzimit, të miratuar sipas legjislacionit në fuqi për pyjet dhe kullotat. Veprimtaria në minierat

sipërfaqësore lejohet referuar përcaktimeve të legjislacionit përkatës për pyjet dhe kullotat.".

Neni 7

Në nenin 25 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në paragrafin e fundit të nenit 25 fjala "pushimit" zëvendësohet me fjalën "ndërprerjes".

2. Pas fjalisë së fundit shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

"Njoftimi i pezullimit, sipas shkronjës "dh" të këtij neni, miratohet nga ministri për një afat jo më të gjatë se 2 vjet.

Në tri vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë minerare, zotëruesi i lejes minerare nuk mund të paraqesë kërkesë për pezullim të përkohshëm.

Procedurat dhe rregullat për shkaqet dhe mënyrën e njoftimit për pezullim nga ana e zotëruesit të lejes miratohen nga ministri në bashkërendim me strukturat përgjegjëse për veprimtarinë minerare.".

Neni 8

Pika 5 e nenit 31 ndryshohet si më poshtë:

"5. Vlera e garancisë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit, e cila përditësohet çdo 2 vjet, referuar çmimeve të tregut ose të indeksuara, paraqitet së bashku me planin vjetor të veprimtarisë minerare dhe paguhet çdo vit pas vlerësimit nga struktura përgjegjëse.

Metodologjia për përditësimin e vlerave të garancive financiare miratohet nga ministri në bashkërendim me ministrin përgjegjës për mjedisin.".

Neni 9

Në pikën 11 të nenit 36 fjala "tremujore" zëvendësohet me fjalën "gjashtëmujore".

Neni 10

Pika 5 e nenit 37 ndryshohet si më poshtë:

"5. Në rastet kur zotëruesi i lejes minerare braktis zonën e lejes minerare pa njoftim, nuk nis zbatimin e planit të rehabilitimit apo nuk përfundon zbatimin e plotë të planit të rehabilitimit brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, vlera e plotë e garancisë së rehabilitimit të mjedisit kalon në favor të shtetit. Në këto raste rehabilitimi kryhet nga subjekte të specializuara, të përzgjedhura nga struktura përgjegjëse sipas procedurave të prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shpenzimet përballohen me fondet e garancisë financiare.".

Neni 11

Në nenin 38 pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

"10. Mbetjet minerare në vendet e depozitimit të mineraleve metalore do të ruhen nga ana e subjektit dhe do të trajtohen si stok, shoqëruar me dokumentacionin përkatës teknik dhe financiar, me treguesit sasiorë, cilësorë dhe financiarë.".

Neni 12

Në pikën 1 të nenit 44 pas fjalëve "kadastra minerare" shtohen fjalët "e krijuar nga heqja e sipërfaqes nga fondi pyjor e kullosor, pas pajisjes me leje minerare".

Neni 13

Në nenin 45 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja "e" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"e) shkelja e dispozitave të neneve 13, pika 13; 18, pika 1, shkronja "ë"; 20, pika 1, shkronja "c", dhe 25, shkronja "ë", të këtij ligji, me gjobë 300 000 (treqind mijë) lekë për çdo shkelje:".

2. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

"8. Të ardhurat nga gjobat për shkeljet e përcaktuara nga ky ligj i kalojnë në masën 60 për qind strukturës që ka verifikuar shkeljen, me qëllim përmirësimin e shërbimit, në zbatim të këtij ligji, kurse 40 për qind i kalojnë shtetit.".

Neni 14

Shkronja "c" e pikës 1 të nenit 47 ndryshohet si më poshtë:

"c) Zotëruesi i lejes minerare pezullon ose ndërpret veprimtarinë minerare pa miratimin e ministrisë.".

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.12.2025

Shpallur me dekretin nr. 502, datë 23.12.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 502, datë 23.12.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 75/2025, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, 'Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 76/2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 95/2015, "PËR SHËRBIMET DHE PRODUKTET BIOCIDE NË SHËNDETIN PUBLIK", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 95/2015, "Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përmirësimi i funksionimit të tregut të brendshëm nëpërmjet harmonizimit të rregullave për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve biocide, duke siguruar mbrojtjen në nivel të lartë të shëndetit të njerëzve, të kafshëve dhe mjedisit.".

Neni 2

Në shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 3 pas fjalëve "lëndët kozmetike." shtohen fjalët "dhe për sigurinë e lodrave.".

Neni 3

Në nenin 4 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në fund të nënndarjes "i" të shkronjës "a" shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Për qëllime të këtij ligji, termat "substancë" dhe "përzierje" kanë kuptimin sipas përkufizimeve në nenin 5 të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve", të ndryshuar.".

b) Shkronja "d" shfuqizohet.

c) Në fund të shkronjës "e" shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

"Një substancë e tillë, nëse nuk ka arsye të tjera për shqetësim, përfshin:

- një substancë e klasifikuar si e rrezikshme ose që plotëson kriteret për klasifikimin si e rrezikshme sipas legjislacionit për klasifikimin e kimikateve dhe që është e pranishme në produkt biocid në një përqendrim, që bën që produkti të konsiderohet i rrezikshëm;

- një substancë, që plotëson kriteret për të qenë një ndotës organik i qëndrueshëm (POP) sipas legjislacionit për ndotësit organikë të qëndrueshëm ose që plotëson kriteret për të qenë i qëndrueshëm, bioakumulues dhe toksik (PBT) ose shumë i qëndrueshëm dhe shumë bioakumulues (shQshB), sipas legjislacionit për substancat me rrezikshmëri të lartë.".

ç) Pas shkronjës "o" shtohet shkronja "p" me këtë përmbajtje:

"p) "Produkte biocide të gatshme për përdorim vetjak joprofesional" janë produktet që përmbajnë substanca aktive me veprim dezinfektues, dezinsektues, repellente (largues) ose antimikrobik, të formuluara në mënyrë që mund të përdoren drejtpërdrejt nga përdoruesi, pa qenë e nevojshme hollimi, përzierja ose përgatitja paraprake, dhe që janë të destinuara për përdorim vetjak joprofesional.".

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5
Klasifikimi, etiketimi dhe paketimi i produkteve biocide

Rregullat për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e produkteve biocide miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.".

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8
Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide

1. Produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, vendosen në treg pas pajisjes me autorizim nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

2. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për:

a) produkte biocide të prodhuara në vend, por të autorizuara paraprakisht në një nga vendet e Bashkimit Evropian;

b) produkte biocide të importuara dhe të autorizuara paraprakisht në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, pavarësisht vendit të origjinës.

3. Për pajisjen me autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, personi fizik ose juridik, në cilësinë e kërkuesit, duhet të ketë të punësuar një drejtues teknik të diplomuar në mjekësi, shëndet publik, kimi, biologji ose agronomi.

4. Kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedura e dhënies së autorizimit për vendosjen në treg të produkteve biocide, si dhe autorizimit të kushtëzuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

5. Miratimi i lëndëve vepruese, i përbërësve të tjerë në përmbajtje të produkteve biocide, si dhe përditësimi i tyre në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

6.Miratimi i të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të produkteve biocide, si dhe përditësimi i tyre në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.".

Neni 6

Pas nenit 8 shtohen nenet 8/1 dhe 8/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 8/1
Autorizim i kushtëzuar për vendosjen në treg të produkteve biocide

1. Ministri përgjegjës për shëndetësinë lëshon autorizimin e kushtëzuar për vendosjen në treg të produkteve biocide gjatë periudhave të epidemive ose fatkeqësive natyrore vetëm për produktet biocide, që janë të autorizuara në një nga vendet e Bashkimit Evropian, pavarësisht vendit të origjinës.

2. Autorizimi i kushtëzuar për vendosjen në treg të produkteve biocide është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe lëshohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, me propozim të Institutit të Shëndetit Publik, brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga kërkesa.

3. Rregullorja për dhënien e autorizimit të kushtëzuar për vendosjen në treg të produkteve biocide miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 8/2
Mbajtja e të dhënave dhe raportimi

Mbajtësit e autorizimit ruajnë dhe mbajnë të dhënat për produktet biocide që ata vendosin në treg për të paktën 3 vjet pas vendosjes në treg ose 3 vjet pas datës së shfuqizimit ose mbarimit të afatit të autorizimit, cilado qoftë më herët. Informacionin përkatës të pasqyruar në këto të dhëna ata do ta vendosin në dispozicion të strukturave përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, sipas kërkesës.".

Neni 7

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 9/1
Tregtimi i produkteve biocide

1. Lejohet tregtimi me shumicë dhe me pakicë i produkteve biocide të autorizuara.

2. Tregtimi me shumicë dhe me pakicë i produkteve biocide bëhet nga personi fizik ose juridik, që ka të punësuar në pozicionin e drejtuesit teknik një person të diplomuar në mjekësi, shëndet publik, kimi, biologji ose agronomi.

3. Tregtimi i produkteve biocide bëhet nga personi fizik ose juridik i licencuar sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

4. Përjashtohet nga përcaktimet e pikave 2 dhe 3 të këtij neni një kategori e caktuar e produkteve biocide të gatshme për përdorim vetjak joprofesional në ambalazhime të veçanta. Lista e këtyre produkteve biocide miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

5. Rregullat për tregtimin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.".

Neni 8

Pika 4 e nenit 10 ndryshohet si më poshtë:

"4. Rregullat për transportin e produkteve biocide miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.".

Neni 9

Neni 13 shfuqizohet.

Neni 10

Pas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 13/1
Struktura përgjegjëse për produktet biocide në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë

Struktura përgjegjëse për produktet biocide në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë ka këto detyra:

a) të ushtrojë funksionin e Sekretariatit të Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide me detyrat si më poshtë:

i. të shqyrtojë paraprakisht kërkesat për autorizimin e produkteve biocide, të paraqitura në platformën elektronike *e-Albania;*

ii. të koordinojë korrespondencën për dhënie mendimi pranë Institutit të Shëndetit Publik në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në fushën e produkteve biocide;

iii. të asistojë në mbledhjet e Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide dhe të administrojë dokumentacionin përkatës të mbledhjeve;

b) të kontribuojë në grupet e punës ndërinstitucionale për hartimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e produkteve biocide;

c) të propozojë dhe kontribuojë në hartimin e politikave kombëtare në fushën e produkteve biocide në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të ministrisë dhe institucionet e tjera përkatëse;

ç) të koordinojë dhe të raportojë pranë institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e kimikateve lidhur me të dhënat dhe informacionin për produktet biocide të autorizuara.

Neni 11

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14
Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide

1. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide është organ kolegjial teknik i përhershëm dhe vendimmarrës.

2. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

a) përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, i cili kryeson komisionin;

b) drejtuesi i strukturës përgjegjëse, që mbulon produktet biocide në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;

c) një përfaqësues nga Instituti i Shëndetit Publik;

ç) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin;

d) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë;

dh)një përfaqësues nga institucioni përgjegjës për kontrollin e produkteve biocide.

3. Sekretar i Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide është specialisti që mbulon çështjet e produkteve biocide, pjesë e strukturës dhe organikës së ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe kryen procedurën e autorizimit të produkteve biocide.

4. Anëtarët e Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, me propozimin e institucioneve përkatëse.

5. Mënyra e funksionimit të Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

6. Anëtarët e komisionit marrin shpërblim për pjesëmarrje në mbledhje sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.".

Neni 12

Pika 1 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

"1. Instituti i Shëndetit Publik ka për detyrë:

a) të bëjë vlerësimin e dokumentacionit teknik të produkteve biocide në procedurën e autorizimit dhe ta paraqesë zyrtarisht pranë Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;

b) të kryejë analizat kimike të produkteve biocide të vendosura në treg sipas planit të monitorimit, të miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;

c) të monitorojë dëmtuesit, të përcaktojë statusin e tyre dhe metodat e kontrollit;

ç) të kryejë trajnimin e personelit përgjegjës për monitorimin e aplikimit të produkteve biocide në shëndetin publik në institucionet e varësisë së ministrisë.".

Neni 13

Pika 4 e nenit 20 shfuqizohet.

Neni 14

Pas shkronjës "dh" të pikës 1 të nenit 21 shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje:

"e) shkelja e detyrimit të mbajtësit të autorizimit për mbajtjen e të dhënave dhe raportimin, sipas përcaktimeve në nenin 8/2 dënohet me gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.".

Neni 15
Miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 4; 8/1, pika 3; 9/1, pika 5, dhe 14, pika 5, të ligjit.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për shëndetësinë të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pikat 5 e 6, dhe 9/1, pika 4, të ligjit.

Neni 16
Dispozitë kalimtare

Për aplikimet për autorizim të produkteve biocide, që janë në proces në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vijon procedura sipas parashikimeve ligjore në fuqi, në momentin e kryerjes së aplikimit.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 503, datë 23.12.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 503, datë 23.12.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 76/2025, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 95/2015, 'Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik', i ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 77/2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 15/2015 "PËR ROLIN E KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 15/2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshon si më poshtë:

"Për rolin e Kuvendit në procesin e negociatave dhe anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian".

Neni 2

Kudo në përmbajtje të ligjit emërtimi "Komisioni për Çështjet Europiane" zëvendësohet me emërtimin "komisioni përgjegjës për çështjet europiane".

Neni 3

Në nenin 1 fjala "integrimit" zëvendësohet me togfjalëshin "negociatave dhe anëtarësimit".

Neni 4

Neni 2 ndryshon si më poshtë:

"Neni 2
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për rolin e Kuvendit në procesin e negociatave dhe anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.".

Neni 5

Neni 3 ndryshon si më poshtë:

"Neni 3
Fusha e veprimit të ligjit

Fusha e veprimit të këtij ligji ka të bëjë me:

a) rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërmjet Kuvendit, Këshillit të Ministrave, ministrit dhe/ose kryenegociatorit përgjegjës për negociatat me Bashkimin Europian, institucioneve të pavarura ose të krijuara me ligj, në kuadër të negociatave me Bashkimin Europian;

b) monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe të politikave në lidhje me procesin e negociatave dhe anëtarësimit, si dhe të asistencës financiare të ofruar nga Bashkimi Europian;

c) monitorimin e procesit të negociatave;

ç) procedurat për miratimin e akteve ligjore që përafrojnë legjislacionin shqiptar me *acquis* të Bashkimit Europian dhe akteve ligjore për plotësimin e kushteve dhe kritereve për anëtarësim;

d) informimin dhe komunikimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për procesin e

negociatave dhe efektet e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.".

Neni 6

Në nenin 4 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja "gj" ndryshon si më poshtë:

"gj) "pozicion negociues" është pozicioni që do të prezantojë Republika e Shqipërisë për kapituj ose grup-kapituj të caktuar.".

2. Pas shkronjës "gj" shtohen shkronjat "h", "i", "j", "k", "l", "ll" dhe "m" me këtë përmbajtje:

"h) "Grup-kapitull" është një grupim kapitujsh bazuar në metodologjinë e rishikuar për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Europian, miratuar nga Bashkimi Europian në vitin 2020, sipas ndarjes në 6 grup-kapituj tematikë.

i) "Qëndrimi i Përbashkët i BE-së" është qëndrimi dhe objektivat e unifikuar të përcaktuar nga Shtetet Anëtare të BE-së për procesin e aderimit në Bashkimin Europian.

j) "Piketat hapëse, të ndërmjetme dhe përmbyllëse" janë kushte dhe objektiva specifikë të vendosur nga Bashkimi Europian që një vend kandidat duhet të përmbushë për të arritur përparim gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit në BE, veçanërisht për hapjen dhe mbylljen e përkohshme të kapitujve negociues.

k) "Plani i përafrimit" është lista e akteve ligjore dhe rregullatore dhe/ose e masave shoqëruese të tjera që hartohen, miratohen dhe zbatohen për të përafruar legjislacionin kombëtar me *acquis* të BE-së në një periudhë të caktuar kohore dhe/ose për të përmbushur piketat.

l) "Procedura e përshpejtuar" për miratimin e ligjeve, që synojnë përafrimin me *acquis* të Bashkimit Europian, është një proces legjislativ i posaçëm, i cili lejon shqyrtimin dhe miratimin më të shpejtë të projektligjeve, që lidhen me detyrimet e Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Europian.

ll) "Procesi i negociatave dhe anëtarësimit" në Bashkimin Europian është një proces politik, juridik dhe institucional përmes të cilit një shtet kandidat harmonizon dhe përshtat legjislacionin, institucionet dhe politikat e tij me *acquis*, me qëllim përmbushjen e kritereve të anëtarësimit dhe kushteve të tjera të vendosura nga BE-ja.

m) "Procesi i anëtarësimit" në Bashkimin Europian është procedura formale me anë të së cilës një shtet kandidat zhvillon negociatat me BE-në, hap dhe mbyll kapitujt e *acquis*, përmbush kriteret e përcaktuara dhe, pas përfundimit të tyre me sukses, nënshkruan dhe ratifikon Traktatin e Anëtarësimit që i jep statusin e shtetit anëtar.".

Neni 7

Neni 5 ndryshon si më poshtë:

"Neni 5
Parimet dhe objektivat e përgjithshëm

Procesi i negociatave dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian bazohet në parimet dhe objektivat e mëposhtëm:

a) promovimi dhe mbrojtja e interesave strategjike kombëtare të Shqipërisë;

b) përmbushja e kritereve politike, ekonomike, ligjore dhe institucionale të kërkuara për anëtarësimin në BE;

c) respektimi i parimeve të shtetit të së drejtës, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të ligjshmërisë, të subsidiaritetit, të proporcionalitetit, të bashkëpunimit reciprok, të transparencës, të gjithëpërfshirjes dhe të ekonomisë së tregut.".

Neni 8

Në nenin 6 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1 togfjalëshi "për integrimin europian" zëvendësohet me togfjalëshin "për anëtarësimin në Bashkimin Europian".

2. Në fund të fjalisë së pikës 1 fjala "integrim " zëvendësohet me fjalën "anëtarësim".

3. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

"2. Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian bashkëdrejtohet nga bashkëkryetari dhe bashkënënkryetari i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit".

Neni 9

Në nenin 7 në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja " a" ndryshon si më poshtë:

"a) nxit bashkëpunimin midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura, shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e

negociatave dhe anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.".

2. Në shkronjën "e" fjala "kryetarit" zëvendësohet me fjalën "bashkëkryetarëve".

Neni 10

Neni 10 ndryshon si më poshtë:

"Neni 10

Komisioni përgjegjës për çështjet europiane

Komisioni përgjegjës për çështjet europiane është organ i përhershëm i Kuvendit, i cili mbulon çështjet e negociatave dhe anëtarësimit në Bashkimit Europian.

Kompetencat e komisionit përgjegjës për çështjet europiane përcaktohen në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe në këtë ligj.".

Neni 11

Në nenin 12 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

"1. Kuvendi merr pjesë në nisma rajonale dhe europiane të bashkëpunimit ndërparlamentar për çështje të negociatave dhe anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Kuvendi bashkëpunon me Parlamentin Europian dhe parlamentet e Shteteve Anëtare në kuadër të mbështetjes së procesit të negociatave dhe anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.".

Neni 12

Në nenin 13 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit 13 ndryshon si më poshtë:

"Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me Këshillin e Ministrave.".

2. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

"1. Këshilli i Ministrave bashkëpunon dhe bashkëvepron me Kuvendin për çështje që lidhen me:

a) procesin e negociatave për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian;

b) procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar shqiptar me legjislacionin e BE-së;

c) angazhimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit dhe komunikimin në kuadër të procesit të negociatave/anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian;

ç) projektmarrëveshjet dhe konventat që duhen miratuar me Bashkimin Europian në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian;

d) projektaktet që kanë të bëjnë me angazhimet në traktatet e Bashkimit Europian, me përjashtim të akteve administrative;

dh) projektaktet e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë dhe që janë të rëndësishme për Republikën e Shqipërisë;

e) projektaktet që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve të Bashkimit Europian.".

Neni 13

Në nenin 14/1 pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

"2. Komisioni përgjegjës për çështjet europiane e përfshin menjëherë pozicionin negociues dhe shtesat/ndryshimet e tij në kalendarin e punimeve të komisionit dhe e shqyrton jo më vonë se 7 ditë nga data e përfshirjes së pozicionit negociues në kalendarin e punimeve të tij.

3. Në rast se pozicioni negociues dhe shtesat/ ndryshimet e tij nuk janë përfshirë në kalendarin e punimeve të komisionit brenda 3 ditëve nga data e paraqitjes të tij, ai automatikisht konsiderohet i përfshirë në kalendar dhe shqyrtohet jo më vonë se 7 ditë nga data e përfshirjes në kalendar.".

Neni 14

Në nenin 15 pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Kuvendi harton kalendarin e projektligjeve për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Europian në përputhje me planin e përafrimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.".

Neni 15

Në nenin 17 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 1 në fund të fjalisë pas fjalës "përgjegjësisë" shtohen fjalët "dhe rregullave procedurale të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit".

2. Pika 4 ndryshon si më poshtë:

"4. Institucionet propozuese të projektligjit krijojnë bazën e të dhënave të tabelave të përputhshmërisë së ligjeve të miratuara, të përditësuara.".

Neni 16

Neni 17/1 ndryshon si më poshtë:

"Neni 17/1
Procedura e shqyrtimit të ligjeve që synojnë përafrimin

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përfshin menjëherë në programin dhe kalendarin e tij të punimeve dhe shqyrton me procedurë të përshpejtuar ligjet që synojnë përafrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/ose detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit, me përjashtim të ligjeve të parashikuara në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës.".

Neni 17

Në nenin 18 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 2 pas fjalëve "Raportit të Progresit" shtohen fjalët "për procesin e negociatave".

2. Në pikën 3 në fund të fjalisë pas fjalëve "Bashkimi Europian" shtohen fjalët "për anëtarësim".

Neni 18

Neni 19 ndryshon si më poshtë:

"Neni 19
Raportimi në komisionin përgjegjës për çështjet europiane

1. Ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin Europian dhe/ose Kryenegociatori paraqesin në fund të çdo 4-mujori në komisionin përgjegjës për çështjet europiane një raport përmbledhës për:

a) progresin mbi procesin e përafrimit me *acquis* të BE-së;

b) ecurinë e procesit të negociatave dhe anëtarësimit në Bashkimin Europian;

c) ecurinë e ndjekjes së rekomandimeve (të pranuara) të komisionit përgjegjës për çështjet europiane lidhur me pozicionet negociuese.

2. Me kërkesë të komisionit përgjegjës për çështjet europiane ose të 1/3 së anëtarëve të tij, ministri përgjegjës për negociatat dhe/ose Kryenegociatori me Bashkimin Europian thirret për të informuar për çdo çështje që ka të bëjë me negociatat e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.".

Neni 19

Neni 20 ndryshon si më poshtë:

"Neni 20
Raportimi i institucioneve të pavarura

Komisioni përgjegjës për çështjet europiane dhe komisionet e përhershme të Kuvendit, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, mund të thërrasin institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, për të raportuar dhe për të dhënë informacione në çdo kohë për zbatimin e detyrimeve të procesit të negociatave dhe anëtarësimit dhe zbatimin e kuadrit ligjor përkatës.".

Neni 20

Në nenin 23 pika 1 ndryshon si më poshtë:

"1. Kuvendi përcakton rregullat e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për angazhimin dhe informimin e tyre lidhur me angazhimet në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian duke garantuar transparencën e veprimtarisë së tij për çështjet e negociatave dhe anëtarësimit dhe gjithëpërfshirjen e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në këtë proces.".

Neni 21
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 504, datë 24.12.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 504, datë 24.12.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 77/2025, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 15/2015, 'Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian', i ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 87/2025

PËR BUXHETIN E VITIT 2026

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 158 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
BUXHETI

Neni 1
Buxheti

Buxheti për vitin 2026 është:

Të ardhurat	823 057 milionë lekë;
Shpenzimet	886 764 milionë lekë;
Deficiti	63 707 milionë lekë.

Buxheti përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2
Buxheti i shtetit

Buxheti i shtetit për vitin 2026 është:

Të ardhurat	581 159 milionë lekë;
Shpenzimet	644 866 milionë lekë;
Deficiti	63 707 milionë lekë.

Neni 3
Buxheti vendor

Buxheti vendor për vitin 2026 është:

Të ardhurat	97 767 milionë lekë
nga të cilat:	
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	27 814 milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	19 301 milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale (grant performance)	200 milionë lekë;
- të ardhura të tjera	50 452 milionë lekë;
Shpenzimet	97 767 milionë lekë.

Neni 4
Buxheti i sigurimeve shoqërore

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2026 është:

l. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat gjithsej	195 292 milionë lekë;
nga të cilat:	
- kontributet	166 711 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	28 581 milionë lekë;
- Shpenzimet	195 292 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për kategoritë e veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2026, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e

suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar.

Të ardhurat gjithsej	8 796 milionë lekë
nga të cilat:	
- kontributet	3 910 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 886 milionë lekë;
Shpenzimet	8 796 milionë lekë.

3. Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 1 653 milionë lekë dhe bonusi i pensionistëve 10 000 milionë lekë. Ky fond ndahet midis skemave dhe përdoret sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

4. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 4 000 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

5. Rezultati pozitiv në fund të vitit buxhetor paraardhës përdoret për financimin e skemës së sigurimeve shoqërore dhe po në të njëjtën masë zbritet nga transferta e buxhetit të shtetit të vitit 2026, pas miratimit të pasqyrave financiare.

Neni 5
Buxheti i sigurimeve shëndetësore

1. Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2026 është:

Të ardhurat gjithsej	67 332 milionë lekë
nga të cilat:	
- kontributet dhe të tjera	26 345 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	40 987 milionë lekë;
Shpenzimet	67 332 milionë lekë.

2. Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk e tejkalon tavanin prej 13 500 milionë lekësh. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6
Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve për vitin 2026 është:

Të ardhurat gjithsej	3 500 milionë lekë
nga të cilat:	
- të ardhura të tjera	1 000 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	2 500 milionë lekë.
Shpenzimet	3 500 milionë lekë.

Neni 7
Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit

1. Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 5 000 milionë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja.

Ky fond shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelat 1 dhe 3, të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji.

2. Çdo e ardhur në formë granti, me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e fondit të rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenet 1, 2, 3 e 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1, 3 dhe 4, të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji. Fondet që rishpërndahen me vendim të Këshillit të Ministrave nga programet sipas tabelës 1 të këtij ligji, si ato korrente dhe ato kapitale, në fondin e rindërtimit, nuk u nënshtrohen kufijve të përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji.

Neni 8
Fondi rezervë i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II
BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 9
Të ardhurat e buxhetit të shtetit

Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

Grantet	20 249 milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	531 137 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	29 773 milionë lekë.

Neni 10
Deficiti i buxhetit të shtetit dhe financimi i tij

1. Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër se deficiti i përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 45 000 milionë lekësh.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë.

2. Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja është rreth 10 274 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikativë, si më poshtë:

- Huamarrja afatgjatë e destinuar për projekte me vlerë rreth 28 262 milionë lekë;
- Huamarrja në formën e "mbështetjes buxhetore" nga institucione financiare ndërkombëtare me vlerë rreth 17 703 milionë lekë;
- Ripagesa të principalit me vlerë rreth (minus) 36 691 milionë lekë;
- Nënhua për pushtetin vendor me vlerë rreth 1 000 milionë lekë.

3. Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë është rreth 8 433 milionë lekë.

4. Çdo diferencë, që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme, të përmendura në këtë nen, dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice, akumulohet në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë ose, në rast mungese, përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

5. Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2026, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila automatikisht rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.

KREU III
SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 11
Shpenzimet e buxhetit të shtetit dhe përdorimi i tyre

1. Shpenzimet e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

- shpenzime të buxhetit qendror 636 066 milionë lekë;
- fondi rezervë i buxhetit 2 500 milionë lekë;
- kontingjenca për risqet e borxhit 6 300 milionë lekë.

2. Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi për shpenzime korrente dhe kapitale, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Në tabelat 1/1 dhe 1/2, që i bashkëlidhen këtij ligji, përcaktohen kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, përkatësisht për vitet 2027 dhe 2028. Transferta e pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore miratohet vetëm për vitin 2026.

3. Të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tri vitet e ardhshme janë sipas tabelës 4, që i bashkëlidhet këtij ligji.

4. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mund të fillojnë procedurën e prokurimit të fondeve që në muajin shtator të vitit korrent, nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për vitin 2027 dhe në vijim, me kushtin që kjo kontratë të bëhet efektive vetëm pas miratimit të ligjit të buxhetit përkatës.

5. Kriteret bazë, masa e përfitimit, mënyra e përdorimit të fondit, të përcaktuara në shpenzimet korrente të programit buxhetor "Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun" në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi i parashikuar për t'u përdorur për financimin e objekteve, pajisjeve dhe makinerive të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, si dhe veprave

të mbrojtjes nga përmbytja të bashkive në zërin "Shpenzime kapitale" në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes" të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, akordohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Fondi prej 300 milionë lekësh, i parashikuar në programin buxhetor "Ekzekutimi i pagesave të ndryshme" në ministrinë përgjegjëse për financat, përdoret 100 milionë lekë për parafinancimin, bashkëfinancimin dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të detyrimeve doganore për projektet me financim të huaj. Pjesa tjetër prej 200 milionë lekësh përdoret si tavan për grantet e huaja, që përdoren nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në rastet kur ato nuk janë parashikuar në buxhetin fillestar. Procedurat e shpërndarjes së këtij fondi përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e shpenzimeve të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, si dhe në tabelat 1 e 3, që përmenden përkatësisht në nenet 11 e 15 të këtij ligji.

7. Fondi prej 6 800 milionë lekësh në zërin "Shpenzime kapitale me financim të huaj" përdoret për financimin e projekteve që lidhen me planin e rritjes me Bashkimin Evropian, me miratim të Këshillit të Ministrave. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji.

8. Fondi prej 300 milionë lekësh, i parashikuar në programin buxhetor "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi" në Kryeministri, përdoret për mbështetjen e institucioneve me ekspertizë teknike për hartimin e projektakteve ose zbatimin e projekteve të tjera të rëndësisë së veçantë. Shpërndarja e fondit dhe kriteret e përdorimit të tij përcaktohen, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave dhe shtojnë kufijtë e miratuar në tabelën 1, që përmendet në këtë nen.

9. Fondi prej 1 000 milionë lekësh, i parashikuar në programin buxhetor "Tregu i punës", në ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe inovacionin, përdoret për kompensimin e kontributeve të punëdhënësit për koston shtesë, që krijohet si rezultat i rritjes së pagës minimale. Rregullat, kriteret dhe masa e kompensimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12
Numri i punonjësve

1. Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 87 143. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror, i dhënë në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, detajohet nga ministritë dhe institucionet qendrore në përputhje me strukturat e miratuara për çdo institucion varësie. Këshilli i Ministrave mund të rishpërndajë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve të përmendura në tabelën 2 të këtij ligji, si dhe të përdorë numrin rezervë për krijimin e institucioneve/funksioneve të reja.

Për vitin 2026, për një periudhë jo më shumë se gjashtëmujori i dytë i tij, për të finalizuar procesin e mbylljes së veprimtarisë administrative të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, një pjesë e numrit të punonjësve administrativë të këtij institucioni, sipas vendimit të Kuvendit, si dhe fondet përkatëse buxhetore në dispozicion të institucionit kalojnë në programin buxhetor "Veprimtaria gjyqësore kushtetuese" të Gjykatës Kushtetuese.

2. Këshilli i Ministrave përcakton numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror. Rregullat për kontraktimin dhe pagesën e punonjësve të përkohshëm përcaktohen në aneksin 5 që i bashkëlidhet këtij ligji.

3. Për vitin 2026 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore apo nivelet e klasave dhe shtesat mbi pagë me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përllogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve /funksioneve të reja. Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përllogaritur sipas gradave të miratuara.

4. Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 500 milionë lekësh shpërndahet dhe përdoret sipas procedurave, që përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e miratuar në tabelën 1, që përmendet në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 13
Paga e Presidentit të Republikës

Paga e Presidentit të Republikës është 425 000 lekë në muaj dhe indeksohet në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14
Fondi rezervë dhe kontingjenca për risqet e borxhit

1. Fondi rezervë prej 2 500 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Çdo ministri apo institucion qendror buxhetor paraqet kërkesën për përdorimin e fondit rezervë në ministrinë përgjegjëse për financat, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

2. Kontingjenca për risqet e borxhit prej 6 300 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit me ndikim në shpenzimet për interesa.

3. Shumat e shpërndara sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 e 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 15
Transfertat buxhetore për pushtetin vendor

1. Transferta e pakushtëzuar, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shpërndahet ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore paraqitet në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Fondi rezervë nga totali i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme akordohet nga ministri përgjegjës për financat në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për programin buxhetor për infrastrukturën vendore dhe rajonale përdoren sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

3. Transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara në bashkitë shpërndahet sipas anekseve 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij ligji.

4. Numri i personelit administrativ të këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 13.

5. Fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas rregullave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për financat.

6. Fondi për emergjencat civile në masën 1 000 milionë lekë akordohet në programin "Emergjencat civile" të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, sipas kritereve dhe metodologjisë së përcaktuar në aneksin 10 që i bashkëlidhet këtij ligji, që integron vlerësimet e riskut në nivel qarku me tregues financiarë dhe demografikë, ku pesha e riskut të shumëfishtë zë vendin qendror në vlerësimin dhe ndarjen e fondeve për çdo bashki. Ky fond ndahet 500 milionë lekë shpenzime korente dhe 500 milionë lekë shpenzime për investime. Me propozim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, Ministria e Financave miraton rishpërndarjen e fondeve nga një bashki në një bashki tjetër, në varësi të nevojave të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe në varësi të ecurisë së përdorimit të fondeve, pa ndryshuar kufijtë e miratuar të shpenzimeve në tabelën 1 të këtij ligji.

7. Fondi prej 1 500 milionë lekësh në zërin "Shpenzime kapitale" në programin "Emergjencat civile" të Ministrisë se Mbrojtjes ka objekt financimin e projekteve që lidhen me parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe përdoret sipas kritereve në aneksin 6, që i bashkëlidhet këtij ligji. Pasi financon projektet në vazhdim, pjesa tjetër e këtij fondi akordohet për projektet e reja me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Fondi prej 300 milionë lekësh në zërin "Shpenzime kapitale" në programin "Emergjencat civile" të Ministrisë së Mbrojtjes ka objekt financimin e projekteve që lidhen me digat dhe rezervuarët dhe përdoret sipas kritereve në aneksin 7, që i bashkëlidhet këtij ligji. Pasi financon projektet në vazhdim, pjesa tjetër e këtij fondi akordohet për projektet e reja me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Fondi për mbetjet urbane në masën 1 000 milionë lekë akordohet si transfertë e pakushtëzuar sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore për

mbetjet urbane, sipas tabelës 3, që i bashkëlidhet këtij ligji, dhe përdoret/shpërndahet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 8, që i bashkëlidhet këtij ligji.

10. Njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikojnë për financim/bashkëfinancim për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe asaj sportive pranë ministrive përgjegjëse përkatëse. Ministrat përgjegjës nxjerrin udhëzime për kriteret, procedurat, afatet për shpalljen e thirrjes dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

11. Në buxhetin vendor të vitit 2026 akordohen 200 milionë lekë për bashkitë, si grant performance. Kriteret, procedurat dhe treguesit e performancës, që do të përdoren për akordimin dhe shpërndarjen e këtij fondi, përcaktohen në aneksin 9, që i bashkëlidhet këtij ligji, dhe detajohen në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për financat e të ministrit përgjegjës për pushtetin vendor.

Neni 16
Fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë

1. Fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen në formën e grantit. Ky fond shpërndahet sipas kategorive të mëposhtme:

a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;

b) granti i mësimdhënies;

c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

2. Modeli i financimit për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret për përdorimin e granteve të politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë dhe granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese janë përcaktuar në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.

3. Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë mund të shpërndahet edhe te njësitë e vetëqeverisjes vendore në ato raste kur me vendim të Këshillit të Ministrave ato përcaktohen autoritete kontraktore për realizimin e procedurave të prokurimit për studim-projektimin apo zbatimin e projektit për një ose disa institucione të arsimit të lartë. Në këto raste, çelja e fondit nga ministria përgjegjëse për financat bëhet pas paraqitjes së kërkesës nga njësia e vetëqeverisjes vendore përmes ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 17
Rishpërndarja e fondeve buxhetore

Kufiri i shpenzimeve sipas tabelës l, që përmendet në nenin 11 të këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet programeve brenda të njëjtit institucion buxhetor apo ndërmjet programeve të institucioneve të ndryshme nga Këshilli i Ministrave deri në masën 10 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve të përgjithshme kapitale, duke ruajtur totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale.

Të drejtat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë për rishpërndarjen e fondeve buxhetore reflektohen dhe ndryshojnë tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji.

Fondet e parashikuara për projektet e reja të investimeve në masën 20% të vlerës totale të projektit, pas lidhjes së kontratës, mund të rialokohen në masën që lejon plani i zbatimit të kontratës për vitin e parë buxhetor dhe në rast se konfirmohet nga autoriteti kontraktor.

Neni 18
Tavani i kontratave të koncesionit/PPP

Tavani për vlerën totale të kontratave të koncesionit/PPP ekzistuese dhe të kontraktuara rishtazi për vitin 2025, në përputhje me të dhënat e regjistrit të koncesioneve, është 27.1% e PBB-së. Çdo kontratë e re ndjek procedurat dhe rregullat e legjislacionit në fuqi për koncesionet/PPP-të.

Neni 19
Borxhi publik

1. Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore, në dobi të palëve të treta përfituese për vitin 2026, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 62 633 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë:

a) për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 55 274 milionë lekë;

b) për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore, në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 7 359 milionë lekë.

2. Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 492 162 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi si më poshtë:

a) stoku i borxhit i qeverisjes qendrore 1 449 540 milionë lekë;

b) stoku i borxhit i garantuar nga qeverisja qendrore 41 722 milionë lekë;

c) stoku i borxhit i vetëqeverisjes vendore 900 milionë lekë.

Neni 20
Mbështetjet buxhetore nga institucionet financiare ndërkombëtare

1. Në rast të disbursimit të ndonjë kredie shtesë në formën e "mbështetjes buxhetore" nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe në rast të përdorimit të fondeve të përfituara nga alokimi i të drejtave të tërheqjes speciale prej Fondit Monetar Ndërkombëtar, kufijtë përkatës për huamarrjen totale neto, rritjen vjetore të borxhit të qeverisjes qendrore dhe nivelin e vlerësuar të stokut total të borxhit publik, të përcaktuar në nenet 10 dhe 19 të këtij ligji, mund të tejkalohen deri në shumën e vlerave të përmendura më poshtë:

a) vlera e kredive në formën e "mbështetjes buxhetore" të disbursuar;

b) vlera e përdorimit të fondeve të përfituara nga alokimi i të drejtave të tërheqjes speciale prej Fondit Monetar Ndërkombëtar.

2. Niveli i deficitit të buxhetit të vitit 2026 mbetet i pandryshuar, sipas përcaktimit në nenin 1 të këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit, që mund të krijohet dhe të mbartet për të financuar buxhetet e viteve buxhetore pasardhëse, por në mbyllje të vitit buxhetor gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore të planifikuara për atë vit buxhetor.

Neni 21
Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2026.

Miratuar në datën 12.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 505, datë 24.12.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

ANEKS 1

TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR, FORMULA E NDARJES SË FONDEVE, KRITERET DHE KOEFICIENTËT E VITIT 2026

1. Transferta e pakushtëzuar

Transferta e Pakushtëzuar (TP) rregullohet nga ligji nr. 68, datë 27.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, i cili përcakton madhësinë dhe mënyrën e ndarjes për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV). Si rregull i përgjithshëm, transferta e pakushtëzuar ka për qëllim t'u sigurojë njësive të vetëqeverisjes vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal). Duke qenë se NJVQV-të janë të ndryshme për sa i përket nevojave dhe kapacitetit fiskal, në një sistem efikas dhe të drejtë të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar duhet të merren parasysh diferencat tek të dy dimensionet.

Për vitin 2026, transfertat në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore janë:

- Transferta e pakushtëzuar e cila përbëhet nga:

a) Pjesa e përgjithshme prej 27 814 milionë lekë që rezulton nga zbatimi i pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, i cili

përcakton se madhësia e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2026 është jo më pak se 1% e Produktit të Brendshëm Bruto dhe jo me pak se ajo e vitit 2025;

b) Pjesa sektoriale prej 14 801 milionë lekë nga shtesa që rezulton nga zbatimi i pikës 3, të nenit 95, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", për përfundimin e periudhës tranzitore për financimin me transferta specifike të funksioneve të decentralizuara nga ky ligj, dhe zbatimi i pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" që rregullon konvertimin e transfertave specifike për funksionet e decentralizuara rishtazi në nivel vendor në transfertë të pakushtëzuar sektoriale;

c) Granti i performancës prej 200 milionë lekë si një mekanizëm financiar që mbështet bashkitë të cilat performojnë më mirë; dhe

d) Për pagat, prej 4 500 milionë lekë nga shtesa që rezulton nga zbatimi i vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 328, datë 31.5.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, si dhe nga politika e re e pagave për vitin 2026.

Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2026, që rezulton nga përcaktimi ligjor i madhësisë minimale prej 1% të PBB-së ose prej 27 814 milionë lekë, do të shtohet fondi prej 4 500 milionë lekë për kompensimin e pagave dhe fondet prej 15 001 milionë lekë, për financimin e funksioneve të transferuara në vitin 2016 dhe për financimin e grantit të performancës. Në total, për vitin 2026, transferta e pakushtëzuar do të jetë 47 315 milionë lekë.

Formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përcaktohet në nenin 24, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Formula identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia rezidente, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

2. Shuma totale e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2026

Në zbatim të pikave 2 dhe 4, të nenit 23, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", dhe pikës 3, të nenit 95, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", **madhësia e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2026 është 47 315 milionë lekë**, dhe përbëhet nga pjesa e përgjithshme, pjesa e kompensimit të pagave, pjesa sektoriale që mbulon funksionet e decentralizuara në vitin 2016 dhe fondi për grantin e performancës.

Transferta e pakushtëzuar për një bashki ose qark është e barabartë me shumën përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë dhe qarqet, sipas parashikimit të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", fondet për kompensimin e pagave dhe fondeve të ndara sipas çdo bashkie për funksionet e transferuara (decentralizuara) në vitin 2016.

	TOTALI I TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR (PJESA I + PJESA II + PJESA III)	**47,315,330,000**
I	**Pjesa e përgjithshme – Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore**	**27,814,330,000**
1	**Produkti i Brendshëm Bruto i parashikuar për vitin 2026**	**2,781,433,000,000**
2	**Transferta e pakushtëzuar për vitin 2026, në % ndaj PBB-së të parashikuar**	**1%**
3	**Transferta e pakushtëzuar për vitin 2026, në lekë**	**27,814,330,000**
4	**Transferta e pakushtëzuar për t'u shpërndarë sipas formulës në vitin 2026**, pas zbritjes së fondeve, si më poshtë:	**26,125,570,440**
5	*Fondi rezervë*	*100,000,000*
6	*Fondet për Konviktet dhe Qendrat e Shërbimeve Sociale*	*669,513,822*
7	*Fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarqet tek bashkitë*	*592,245,739*

8	*Mbështetje për reformën në financat e arsimit parashkollor*	*327,000,000*
II	**Transfertë sektoriale për kompensimin e pagave**	**4,500,000,000**
III	**Pjesa sektoriale – Funksionet e decentralizuara me ligjin "Për vetëqeverisjen vendore".**	**15,001,000,000**
1	*Fondet për personelin mësimor në kopshte në arsimin parashkollor*	*6,953,608,000*
2	*Fondet për personelin mbështetës në kopshte dhe arsimin parashkollor*	*1,820,929,000*
3	*Fondet për personelin mbështetës në arsimin parauniversitar*	*781,003,000*
4	*Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e mbrojtjes nga zjarri*	*2,314,884,000*
5	*Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e administrimit të pyjeve*	*573,244,000*
6	*Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e ujitjes dhe kullimit*	*1,165,587,000*
7	*Fondet për qendrat e shërbimeve sociale*	*96,544,000*
8	*Fondet për rrugët rurale*	*94,873,000*
9	*Fondet për menaxhimin e mbetjeve urbane*	*1,000,000,000*
10	*Granti i performancës*	*200,000,000*
IV	**Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për t'u shpërndarë me formulë në vitin 2026 (I.4+I.8+III.1)**	**33,406,178,440**

Pjesa e Përgjithshme e Transfertës së Pakushtëzuar (TP) për vitin 2026 është 1% e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të parashikuar për vitin 2026, ose 27,814,330,000 lekë dhe është 1,607,010 mijë lekë më shumë se në vitin 2025. Gjithsej transferta e pakushtëzuar për bashkitë dhe qarqet së bashku me transfertën e pakushtëzuar sektoriale që shpërndahet nëpërmjet formulës është 33,406,178,440 lekë, pas zbritjes së fondeve për konviktet, shërbimet sociale dhe për rrugët rurale. Deri para vitit 2016, fondet për konviktet, shërbimet sociale dhe për disa kritere të tjera, përfshiheshin në transfertën e pakushtëzuar përfundimtare të bashkive respektive. Nëpërmjet kësaj formule të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, këto fonde janë nxjerrë jashtë totalit të transfertës që ndahet me formulë. Duke filluar nga viti 2016, këto fonde paraqiten vetëm tek bashkitë përfituese si transfertë e pakushtëzuar, sikurse janë në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2026. Në totalin e transfertës së pakushtëzuar përfshihen edhe fondet për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, ku nga viti 2016, kanë kaluar nga këshillat e qarqeve tek bashkitë. Gjithashtu, fondet për këtë funksion nuk ndahen sipas formulës së transfertës së pakushtëzuar dhe paraqiten të veçanta për bashkitë përfituese në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2026.

Në vitin 2026, në zbatim të neneve 28 dhe 37, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 23, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 23, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", vijon reforma e financimit të arsimit parashkollor duke e harmonizuar sistemin me praktikat më të mira ndërkombëtare në financimin e kopshteve. Kostoja e reformës është 327 milionë lekë dhe vazhdon të mbulohet nga transferta e pakushtëzuar e vitit 2026.

Pjesa sektoriale e transfertës së pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e transferuara në nivel vendor në vitin 2016, sipas ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore". Fondet për këto funksione nuk ndahen sipas formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përcaktuar në nenin 24, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Fondet për këto funksione ndahen për çdo funksion dhe për çdo bashki, sipas kritereve specifike të përcaktuara në aneksin nr. 4 dhe në kolonat e veçanta në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse të ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2026.

Buxheti i vitit 2026, vijon vazhdimin e reformës në arsimin parashkollor. Nga viti 2019, dhe në buxhetin edhe në vitin 2026, fondet për arsimin parashkollor ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve me moshë 3–6 vjeç, si treguesi më i mirë i nevojës për shërbim dhe sipas numrit të edukatoreve të transferuara në vitin 2016. Më specifikisht, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve ndahen numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Kjo siguron një ndarje më të mirë të fondeve, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që duhet t'u ofrohet edukimi parashkollor. Ky mekanizëm është në përputhje me parashikimet e neneve 28 dhe 37, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012,

"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe praktikat e mira ndërkombëtare që rekomandojnë një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve.

Ky mekanizëm siguron:

- Uljen e madhësisë mesatare të grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti mesatar 18 fëmijë për një edukatore (para reformës) në raportin 15 fëmijë për një edukatore;

- Shtimin e fondeve në ato bashki ku ka një nevojë reale për shtimin e numrit të edukatoreve, duke ulur madhësinë maksimale të grupeve nga 26 apo 25 fëmijë për një edukatore (para reformës) në 18 fëmijë për edukatore, një parakusht për përmirësimin e cilësisë së edukimit për fëmijët nga 3–6 vjeç që ndjekin kopshtet publike;

-Ruajtjen e fondeve aktuale për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht "të lartë" edukatorësh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera;

- Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatoreve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive për sa i përket raportit fëmijë për edukatore;

- Shtim fondi për stafin mbështetës të arsimit parashkollor.

Në buxhetin e vitit 2026, do të ndahen me formulë 33,406,178,440 lekë, ku përfshihen edhe 6,953,608,000 lekë për personelin mësimor në arsimin parashkollor që i përkasin transfertës së pakushtëzuar sektoriale. Fondet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të reja të transferuara në vitin 2016, paraqiten në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2026.

3. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme ndërmjet dy niveleve të qeverisjes vendore

Për vitin 2026, për financimin e funksioneve të veta bashkitë marrin 97% të totalit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për t'u ndarë me formulë, ose **25,355,570,440 lekë**.

Funksionet e transferuara te bashkitë në vitin 2016, financohen nëpërmjet transfertave të pakushtëzuara sektoriale me kolona të veçanta në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2025. Fondet për arsimin parashkollor në këtë buxhet janë shpërndarë sipas një formule e cila mbështetet kryesisht në numrin e fëmijëve me moshë 3–6 vjeç.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme ndërmjet dy niveleve të qeverisjes	Në përqindje	Vlera në lekë
Transferta e pakushtëzuar për bashkitë	**97.1%**	**25,355,570,440**
Transferta e pakushtëzuar për qarqet	**2.9%**	**770,000,000**

4. Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë

Popullsia është një tregues i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Për rrjedhojë popullsia do të vazhdojë të mbetet kriteri kryesor për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore.

Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë		30%
Banorë rezidentë efektivë = [CENSUS + (Regjistri i gjendjes civile – Census)*30%]		**3,073,181**

Të dhënat për popullsinë që përdoren në aplikimin e formulës bazohen kryesisht në të dhënat e Censusit të vitit 2023. Këtyre të dhënave u shtohet 30% e diferencës midis të dhënave të Censusit dhe Gjendjes Civile (të vitit 2025) për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore. Kështu, nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore sipas Censusit të vitit 2023 ka 20,000 banorë, ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile rezulton të ketë 35,000 banorë, atëherë, numri i popullsisë së përdorur për alokimin e fondeve për këtë bashki do të jetë 20,000 + [(35,000-20,000)*30%] = 24,500 banorë të konsideruar rezidentë efektivë në atë njësi të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, popullsia rezidente rezulton rreth 3 milionë banorë, nga 2.4 milionë që raportohet nga Censusi dhe 4.6 milionë që raportohet nga Regjistri i Gjendjes Civile. Vlerësohet se një kompromis midis dy burimeve të të dhënave është i nevojshëm dhe rregullimi me 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe Censusit amortizon ndryshimet në transfertë që do të pësonte një njësi nga kalimi nga një formulë në tjetrën.

5. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë

Për vitin 2026, transferta e pakushtëzuar e cila ndahet sipas formulës për 61 bashkitë është 25,355,570,440 lekë dhe do të ndahet sipas kritereve të mëposhtme. Kriteret e shpërndarjes së fondeve në formulë kërkojnë të identifikojnë nevojat reale të shpenzimeve të njësive të ndryshme të vetëqeverisjes vendore mbi bazën e popullsisë, dendësisë së popullsisë dhe numrit të fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat publike 9-vjeçare dhe të mesme në territorin e një bashkie.

Në formulë, 80% e transfertës së përgjithshme për bashkitë alokohet mbi bazën e popullsisë rezidente. Në vijim të rregullimit të numrit të popullsisë së Censusit, duke i shtuar atij edhe 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe të dhënave të Censusit, çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr një transfertë të pakushtëzuar prej 6,600 lekë, për çdo banor rezident në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë	**25,355,570,440**
Komponenti I: Ndarja sipas popullsisë (në përqindje)	**80%**
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	**20,284,456,352**
Transferta e pakushtëzuar për frymë	**6,600**

Dendësia e popullsisë është një kriter tjetër që përdoret për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë. Dendësia e popullsisë më e ulët është në bashkitë që përbëhen kryesisht ose plotësisht nga zona rurale dhe/ose malore. Ka një korrelacion të fortë mes njësive të vetëqeverisjes vendore me dendësi të ulët dhe atyre sipërfaqja e të cilave është mbi 50% malore. Kështu koeficienti "dendësi e ulët e popullsisë", çon fonde shtesë në të njëjtin drejtim siç bënte formula e mëparshme e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, nëpërmjet përdorimit të koeficientëve shtesë për njësitë vendore malore dhe në vështirësi financiare.

Në formulë 15 % e totalit të transfetës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë, ndahet mbi bazën e dendësisë së popullsisë, e cila ndahet në kufij sipas tabelës së mëposhtme.

Komponenti II: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							**15%**
Madhësia e transfertës së pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							**3,803,335,566**
Mesatarja kombëtare e dendësisë së popullsisë							108 banorë/km²
Transferta për frymë nga densiteti i popullsisë							3,401 lekë/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si përqindje ndaj mesatares kombëtare		**Koeficientet rregullimit**	**Numri i NJVQV-ve përfituese**	**Dendësia e popullsisë korresponduese**	**Popullsia në çdo grup**	**Popullsia e korrektuar me koeficientin e rregullimit për çdo grup**	**Shuma e fondeve shtesë për çdo grup**
Kufiri 1	**22%**	**2.270**	11	23.2	109,592	248,773	846,048,761
Kufiri 2	**43%**	**1.669**	15	46.5	299,520	499,900	1,700,102,135
Kufiri 3	**75%**	**0.900**	8	81.1	244,647	220,182	748,815,237
Kufiri 4	**110%**	**0.350**	5	118.9	219,686	76,890	261,494,582
Kufiri 5	**>110%**	**0.033**	22	>120.1	2,199,736	72,591	246,874,851
Totali			61		3,073,181	1,118,336	3,803,335,566

Një njësi e vetëqeverisjes vendore me një sipërfaqe të madhe dhe një popullsi më të ulët, nënkupton, për të gjitha kushtet e tjera të barabarta, të ketë kosto më të larta të ofrimit të shërbimeve, rrugë më të gjata dhe shpenzime të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Për të kompensuar njësitë me dendësi më të ulët për kostot më të larta të shërbimit janë krijuar 5 grupime të njësive të vetëqeverisjes vendore sipas ngjashmërisë më të madhe të dendësisë. Njësitë me dendësi më të ulët popullsie përfitojnë nga koeficientë shtesë më të lartë se ato njësi të cilat kanë një afërsi më të madhe të dendësisë me mesataren kombëtare. Nga ky kriter përfitojnë të gjitha bashkitë, në të cilat banojnë 3,073,181 banorë rezidentë efektivë. Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka një dendësi mesatare nën 22% të mesatares kombëtare, ose mesatarisht 20 banorë për km², atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me 2.270. Nëse ka një

dendësi midis 22% dhe 43% të mesatares kombëtare, atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me një koeficient prej 1.669. Pra duke u afruar mesatares kombëtare, koeficientët vijnë duke u zvogëluar. Në përfundim numri i popullsisë për çdo grup dendësie, shumëzohet me koeficientin përkatës dhe transfertën për frymë prej **3,401 lekë** për banorë (që rezulton nga pjesëtimi i shumës prej **3,803,335,566 lekë** me popullsinë totale që rezulton nga aplikimi i koeficientëve për çdo grup).

Pjesa prej 5% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë, ose 1,267,778,522 lekë do të ndahet mbi numrin faktik të nxënësve në shkollat publike në çdo bashki, kundrejt totalit kombëtar të nxënësve. Bashkitë do të marrin një fond prej 3,754 lekë për çdo nxënës në territorin e tyre.

Komponenti III: Ndarja sipas numrit të nxënësve (në %)	**5%**
Transferta e pakushtëzuar sipas numrit të nxënësve, në lek	**1,267,778,522**
Transferta për një nxënës	3,754 lekë/nxënës

6. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për bashkitë

Nga viti 2019, dhe në vazhdim transferta e pakushtëzuar sektoriale për arsimin parashkollor ndahet me një formulë. Sipas kësaj formule, 60% e shumës së transfertës së pakushtëzuar sektoriale për arsimin parashkollor ndahet mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Për vitin 2026 me këtë formulë shpërndahen 6,953,608,000 lekë si transfertë e pakushtëzuar sektoriale për arsimin parashkollor.

7. Ekualizimi i transfertës së pakushtëzuar mbi bazën e të ardhurave nga taksat e ndara dhe në raport me transfertën e vitit të mëparshëm

Për të siguruar një ekualizim horizontal efektiv të transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore në mënyrë që të merren në konsideratë kapacitetet e ndryshme fiskale ndërmjet tyre, në formulë llogaritjet bazohen mbi të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore, të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme të cilat mblidhen nga institucionet qendrore dhe u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurohen që të ardhurat që ata mbledhin vetë nuk preken nga sistemi i ekualizimit duke evituar kështu çdo lloj disincentivimi në mbledhjen e taksave. Në vitin 2025, pjesa e të ardhurave nga këto taksa që u janë transferuar njësive të vetëqeverisjes vendore është 4,137,034,007 lekë, dhe të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), ose mesatarja kombëtare për frymë rezulton 1,346 lekë për banor, sipas konceptit "banor rezident efektiv".

<table>
<tr><td colspan="7">Komponenti IV: Sistemi i ekualizimit të të ardhurave</td></tr>
<tr><td colspan="6">Të ardhurat nga taksat e ndara që do të përdoren për ekualizimin e të ardhurave (TAP + Taksa e Automjeteve + Taksa mbi transferimin e pasurisë nga personat juridik)</td><td>4,137,034,007</td></tr>
<tr><td colspan="6">Të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), Të ardhura për frymë (TAPF)</td><td>1,346</td></tr>
<tr><td>Nëse NJVV-të kanë TAPF nën</td><td>91%</td><td>Të TAKPF, atëherë ato kompensohen me</td><td>100%</td><td>Të diferencës</td><td>Madhësia e ekualizimit fiskal (fondet që duhet të shtohen)</td><td>230,727,909</td></tr>
<tr><td>duke u marrë NJVQV-ve me të ardhura për frymë mbi</td><td>120%</td><td>Të mesatares kombëtare (TAKPF)</td><td>70.6%</td><td>Të diferencës</td><td>Fondet që efektivisht shkurtohen</td><td>230,734,525</td></tr>
<tr><td colspan="6">Koeficienti i rishpërndarjes</td><td>1.00</td></tr>
</table>

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë të ardhura për frymë (TAPF) nën 90% të mesatares kombëtare (TAKPF) prej 1,346 lekë/frymë, do të kompensohen me 120% të diferencës ndërmjet të ardhurave të tyre për frymë dhe mesatares kombëtare. Kjo llogaritje tregon sa fonde do duhej t'u shtoheshin njësive me të ardhura më të ulta për t'i sjellë ato në nivelin prej 1,225 lekë/frymë (ku 1,346*91% = 1,225 lekë). Për të sjellë të gjitha bashkitë me të ardhura më "të ulta" në nivelin prej 91% të mesatares kombëtare, njësive me të ardhura më të larta se 120% e mesatares kombëtare, (pra me TAPF

mbi 1,615 lekë/frymë) do t'u merret 70.6% e diferencës midis të ardhurave të tyre për frymë dhe 120% të mesatares kombëtare. P.sh., nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka të ardhura për fryme prej 1800 lekë/frymë, sipas formulës së mësipërme asaj do t'i zbriten 131 lekë/frymë [1800 – (120%*1,346)]*70.6% = 131 lekë/banor. Kjo llogaritje në fund tregon sa janë fondet realisht të disponueshme të cilat mund të transferohen nga njësitë me të ardhura më të larta tek ato më të ultat. Sistemi balancohet automatikisht nëpërmjet një koeficienti të rishpërndarjes i cili përcaktohet nga raporti midis fondeve disponibël për ekualizim dhe fondeve të nevojshme për ekualizim. Për vitin 2026, fondet e nevojshme për ekualizim janë 230,727,909 lekë, ndërkohë që fondet e disponueshme për ekualizim që vijnë nga "taksimi" prej 70.6% të të ardhurave mbi 1,615 lekë/frymë i njësive me të ardhura më të larta janë 230,734,525 lekë dhe për rrjedhojë koeficienti i rishpërndarjes është 1.00.

8. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Qarqet

Qarqeve do t'u ndahen 770 milionë lekë, sipas një shume fikse, të barabartë për secilin nga 12 qarqet, sipas popullsisë rezidente dhe sipas dendësisë së popullsisë në çdo qark kundrejt mesatares kombëtare. Sipas kriterit të parë, 20% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të qarqeve (ose 154 milionë lekë) do të shpërndahet si një shumë fikse prej rreth 12 milionë lekë për secilin nga 12 qarqet.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për qarqet	**770,000,000**
Komponenti I: Shuma fikse për qarqet (në përqindje)	**20%**
Transferta e pakushtëzuar për t'u ndarë sipas shumës fikse	154,000,000
Shuma fikse e transfertës së pakushtëzuar për çdo qark	12,833,333

Sipas kriterit të dytë, 50% e transfertës së pakushtëzuar (ose 385 milionë lekë) do të ndahet përpjesëtimisht sipas popullsisë rezidente në çdo qark, kundrejt popullsisë totale. Të dhënat për popullsinë e qarqeve ndjekin të njëjtin rregullim të bërë për popullsinë e bashkive.

Komponenti II: Ndarja sipas banorëve rezidentë efektivë (në përqindje)	**50%**
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	385,000,000
Transferta e pakushtëzuar për frymë (banorë rezidentë efektivë)	125

Sipas kriterit të tretë, 30% e transfertës së pakushtëzuar (ose 231 milionë lekë) do të ndahen mbi bazën e dendësisë së popullsisë në çdo qark, kundrejt dendësisë mesatare kombëtare.

Komponenti III: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							**30%**
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							231,000,000
Mesatarja kombëtare e dendësisë së popullsisë							108 banorë/km²
Transferta për frymë nga komponenti i dendësisë së popullsisë							334 lek/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si përqindje ndaj mesatares kombëtare		Koeficientët	Numri i qarqeve që përfitojnë	Dendësia e popullsisë për grup	Popullsia për çdo grup	Shuma e shtuar për secilin grup	% e shpërndarjes për grup
Kufiri 1	**90%**	**0,3**	4	97.5	823,200	82,592,655	36%
Kufiri 2	**65%**	**0,5**	3	70.4	563,397	94,210,565	41%
Kufiri 3	**35%**	**1,0**	2	37.9	162,054	54,196,780	23%
Totali			9		1,548,651	231,000,000	

Qarqet me dendësi më të ulët të popullsisë, duke prezumuar kosto më të larta për ofrimin e shërbimeve dhe/ose kapacitet fiskal më të ulët, do të përfitojnë fonde shtesë nëpërmjet koeficientëve të përcaktuar më sipër për secilin nga tre grupet. Qarqet janë ndarë në tre grupe të ndryshëm sipas raportit mes dendësisë së tyre të popullsisë dhe mesatares kombëtare. Kufijtë e ndarjes së grupeve ndjekin ngjashmërinë e raportit të dendësisë ndaj mesatares kombëtare. Kështu, nëse një Qark ka një dendësi të

populllsisë nën 35% të mesatares kombëtare, që nënkupton mesatarisht më pak se 37 banorë për km², kundrejt mesatares kombëtare prej 108 banorë për km², dhe një popullsi prej 93,225 banorësh rezidentë, atëherë popullsia e atij qarku shumëzohet me koeficientin shtesë përkatës (+1) dhe transfertën për frymë prej 334 lekë për banor, duke rezultuar në një shtesë fondesh prej 31,137,150 lekë (i llogaritur në këtë mënyrë: 93,225*1*334).

ANEKS 2

KRITERET E SHPËRNDARJES SË FONDIT REZERVË

Nivelet e pushtetit vendor	Kriteret
A. Për bashkitë	- Kompensim për ndonjë gabim në përllogaritjen e kritereve të formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2026. - Për funksionet e reja të transferuara tek bashkitë që nga viti 2016. - Për nevoja të ndryshme financiare të bashkive.
B. Për qarqet	- Për shpenzime të ndryshme që mund të nevojiten gjatë vitit.

Shuma që akordohet nga fondi rezervë për njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk duhet të kalojë 50 për qind të nivelit të transfertës së pakushtëzuar të akorduar me ligjin e buxhetit të vitit 2026.

Pjesa e papërdorur e fondit rezervë në vitin buxhetor 2026, kalon në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2027.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin plotësues të zbatimit të buxhetit të vitit 2026.

ANEKS 3

PROGRAMI BUXHETOR PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE DHE RAJONALE NË FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimin e projekteve të reja miratohen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit administron nevojat dhe propozimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe aktorë të tjerë (përfshirë FSHZH dhe njësitë e zhvillimit rajonal të tij) që konsistojnë në projekte në interes dhe në funksion të zhvillimit lokal e rajonal, përfshirë edhe projekte zhvillimore me natyrë ekonomike, të zbatuara në partneritet midis FSHZH dhe njësive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera.

4. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

5. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastruktura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit

mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

6. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, brenda vitit 2026, përmbyll procesin e financimit të projekteve të pa financuara nga ish-Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (infrastruktura vendore dhe rajonale). Për këtë ai rakordon me të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe financon ato projekte që kanë dokumentacion të rregullt ligjor. Të gjitha projektet e tjera që nuk përmbushin kriteret ligjore u kthehen njësive të vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar arsyet e kthimit të tyre.

ANEKS 4
PËR FUNKSIONET E TRANSFERUARA NË NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

1. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e vitit 2026, disa bashkive u janë akorduar fondet për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen fondet për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), për shpenzimet operative dhe për shpenzime për investime.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

2. Qendrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën e vitit 2026 të bashkive, Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë dhe Kukës janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin dhe shpenzime operative për qendrat, "Lira", Berat, "Balash", Elbasan, "Shpresa" Shkodër, "Opera Della Madonnina Della Grappa", Shkodër, "Besa" Vau i Dejës, "Horizont", Fier dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për bashkitë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë, dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këto qendra.

3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)

Në transfertën e vitit 2026 të bashkive, është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Ministria e Punëve të Brendshme duhet t'u dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën e vitit 2026, njësive të vetëqeverisjes vendore u janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

5. Rrugët rurale

Në transfertën e vitit 2026, njësive të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rurale.

6. Administrimi i pyjeve

Në transfertën e vitit 2026, njësive të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes

vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

7. Ujitja dhe kullimi

Në transfertën e vitit 2026, njësive të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

ANEKS NR. 5

PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË PËRKOHSHME

Për kontraktimin e punonjësve me kohë të pjesshme mbi numrin organik të punonjësve të institucioneve buxhetore për vitin 2026, ndiqen këto rregulla:

1. Aktivitetet që nuk mund të realizohen nga punonjësit organik në kuadër të veprimtarisë së tyre vjetore në njësitë e qeverisjes qendrore, konsiderohen si shërbime dhe realizohen me sipërmarrje (nëpërmjet të tretëve), duke zbatuar legjislacionin në fuqi për prokurimin. Në rastet kur nuk mund të realizohen me sipërmarrje dhe/ose sipërmarrja ka kosto më të lartë, këto aktivitete të realizohen nëpërmjet marrjes së punonjësve me kontratë të përkohshme.

2. Aktivitetet që kryejnë punonjësit me kontratë është kryesisht veprimtari e njësive strukturore mbështetëse/rregullatore/shërbimi të institucionit. Aktivitetet në fushën e konsulencës, ekspertizës, inspektimit, auditimit, këshillimit, sigurisë fizike, dhe teknologjisë së informacionit nuk realizohen nëpërmjet punonjësve me kontratë të përkohshme. Shërbimi i ofruar prej tyre i nënshtrohet procedurave përkatëse të prokurimit publik apo akteve të veçanta ligjore në fuqi.

Përjashtimisht, për aktivitetet që lidhen me mësimdhënien, veprimtarinë bujqësore, veprimtarinë statistikore, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, rregullat dhe procedurat e marrjes në punë të tyre, përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të miratuar mes institucionit qendror përgjegjës dhe ministrisë përgjegjëse për financat.

3. Kontraktimi i punonjësve bëhet në përputhje me kriteret e parashikuara për atë pozicion pune, për një periudhë kohore deri në 6 muaj gjatë një viti buxhetor me kohë pune ditore të plotë, ose deri në 6 orë në ditë përgjatë vitit buxhetor.

Përjashtim nga ky përcaktim, bën kontraktimi i punonjësve që kryejnë një veprimtari që realizon të ardhura dytësore, përdorimi i të cilave parashikohet në ligjin vjetor të buxhetit, për këtë qëllim.

4. Paga e punonjësve me kontratë të përkohshme, përcaktohet në referencë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pozicionin për të cilin ai kontraktohet.

Përjashtimisht, për pozicionin "Specialist", paga e punonjësit me kontratë të përkohshme në institucionet e pavarura dhe aparatet e ministrive nuk kalon nivelin e klasës IV-2 dhe në institucionet në varësi të tyre, nivelin e klasës IV-3. Në rast se ky pozicioni ka shtesa specifike mbi pagën e klasës përkatëse, ato nuk përfitohen nga punonjësi, me përjashtim të shtesës mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin.

5. Përjashtohen nga përcaktimet e pikës 3 dhe 4 të këtij Aneksi, punonjësit e kontraktuar përkohësisht në aparatin e Kryeministrisë dhe punonjësit e angazhuar si specialistë (asistent/ndihmës ligjorë) në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

6. Pagesa bëhet në përputhje me procedurat e kryerjes së pagesave për punonjësit organik dhe përfshihet në shpenzimet e personelit të institucionit. Përjashtim nga ky rregull, bëjnë anketuesit/kontrollorët e terrenit të kontraktuar në realizimin e Censusit dhe anketimeve afatshkurta (më pak se dy javë) si dhe operatorët teknik për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit në qendrat e votimit, pagesa e të cilëve e bazuar në ditët e punës, përfshihet në shpenzimet operative të institucionit.

7. Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës për Financat, miraton numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme.

8. Institucioni duhet të ketë fondet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të personelit kontraktuar.

ANEKS 6

FONDI PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E FATKEQËSIVE NATYRORE

1. Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore është një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore e të tjera.

2. Për vitin 2026, Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore është pjesë e fondit të akorduar në buxhetin e vitit 2026 në programin "Emergjencat Civile", në Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Vlerësimi i projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore aplikuese bëhet me vendim të Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, i cili kryesohet nga drejtori i AKMC – kryetar dhe ka në përbërje anëtarë nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile), anëtarë nga Ministria e Mbrojtjes, anëtar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe anëtarë nga Shoqata për Autonomi Vendore.

4. Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore miraton; specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve në infrastrukturë dhe për blerje pajisjesh për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore si dhe vlerësimin e projekteve.

5. Sekretariati teknik për Fondin e Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore ngrihet pranë AKMC dhe ndihmon punën e Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore.

6. Fondi i Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve tashmë në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime midis projekteve të Fondit të Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

7. Thirrjet për aplikim në Fondin Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore për vitin buxhetor 2026, fillojnë që në nëntor të vitit 2025 deri në 15 shkurt të vitit 2026.

8. Fondi prej 200 milionë lekë nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore përdoret nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) për sigurimin e pajisjeve speciale për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, në bashkëpunim me strukturat e industrisë ushtarake dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

9. Projektet e përzgjedhura nga Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dërgohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave brenda datës 1 mars 2026.

10. Këshilli i Ministrave miraton projektet e reja fituese, si dhe autoritetin kontraktor për zbatimin e projekteve të reja sipas njësive të vetëqeverisjes vendore brenda datës 15 mars 2026.

11. Fondi i Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

12. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

ANEKS 7
FONDI PËR DIGAT

1. Fondi për Digat është një mekanizëm financiar që mbështet **rehabilitimin/ rikonstruksionin e digave të rezervuarëve**, duke mbështetur politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit të fatkeqësive natyrore.

2. Për vitin 2026, Fondi për Digat është pjesë e fondit të akorduar në buxhetin e vitit 2026, në programin "Emergjencat Civile", në Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Vlerësimi i projekteve që përfshim, studimin dhe projektin e zbatimit sipas njësive të vetëqeverisjes vendore aplikuese bëhet me vendim të Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore.

4. Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore kryesohet nga drejtori i AKMC – kryetar dhe ka në përbërje anëtarë nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile), anëtarë nga Ministria e Mbrojtjes, anëtarë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, anëtarë nga Shoqata për Autonomi Vendore, dhe bashkëpunon edhe me Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha.

5. Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore miraton specifikimet, rregullat dhe kriteret **për financimin e projekteve për rehabilitimin dhe rikonstruksionin e digave të rezervuarëve** si dhe vlerësimin e projekteve.

6. Sekretariati teknik për Fondin për Digat ngrihet pranë AKMC dhe ndihmon punën e Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore.

7. **Fondi për Digat** me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve tashmë në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me ecurinë e projektit dhe Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime mes projekteve të Fondit për Digat sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

8. Thirrjet për aplikim në Fondin për Digat për vitin buxhetor 2026, fillojnë nga nëntori 2025 dhe deri në 15 shkurt 2026.

9. Projektet e përzgjedhura nga Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dërgohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave brenda datës 1 mars 2026.

10. Këshilli i Ministrave miraton projektet e reja fituese, si dhe autoritetin kontraktor për zbatimin e projekteve të reja sipas njësive të vetëqeverisjes vendore brenda datës 15 mars 2026.

11. Fondi për Digat nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

12. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

ANEKS 8
PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE NË NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

1. Fondet shtesë për menaxhimin e mbetjeve urbane akordohen si transfertë e pakushtëzuar sektoriale sipas tabelës nr. 3 "Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2026". Këto fonde janë një mekanizëm financiar shtesë që mbështet bashkitë për mirëmenaxhimin e mbetjeve urbane.

2. Detajimi i këtyre fondeve në tabelën nr. 3 "Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2026", sipas bashkive është bërë duke marrë parasysh: a) sasinë e mbetjeve vjetore dhe b) kostot shtesë për transportin e tyre në pikat fundore të grumbullimit dhe përpunimit.

3. Detajimi i fondeve është bërë për bashkitë:

a) Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Lezhë dhe Kurbin për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Shkodër;

b) Krujë, Durrës, Vorë, Kamzë, Shijak, dhe Kavajë për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Tiranë;

c) Librazhd, Elbasan, Rrogozhinë, Peqin, Cërrik, Belsh, Përrenjas dhe Gramsh, për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Shkodër;

d) Himarë, Sarandë, Gjirokastër, Tepelenë, Memaliaj, Këlcyrë, Përmet, Libohovë dhe Dropull, për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Gjirokastër;

e) Fier, Lushnjë, Roskovec, Patos, Divjakë dhe Mallakastër, për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Shkodër;

f) Pogradec, Korçë, Kolonjë, Maliq, Devoll dhe Pustec, për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Korçë.

4. Ministria e Mjedisit u dërgon bashkive kuadrin ligjor, nënligjor, standardet dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me menaxhimin e mbetjeve urbane. Njësitë e vetëqeverisjes vendore shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për transportimin e mbetjeve urbane në zonat e menaxhimit të mbetjeve.

ANEKS 9
GRANTI I PERFORMANCËS PËR BASHKITË

1. Granti i Performancës është një mekanizëm financiar që mbështet bashkitë të cilat performojnë më mirë.

2. Qëllimi i Grantit të Performancës, është të nxisë bashkitë të përmirësojnë proceset e qeverisjes në nivel vendor, që së bashku me kornizën e përmirësuar të politikave, të çojë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Ky fond akordohet bazuar në kritere performance duke ofruar incentiva për bashkitë për të përmirësuar performancën e tyre.

3. Granti i Performancës është një mekanizëm i bashkëfinancuar nga qeveria Shqiptare dhe Qeveria

e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), bazuar në marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin "Bashki të Forta (BTF), Faza 2", të ratifikuar me ligjin nr. 114/2024.

4. Për vitin 2026, fondi për grantin e performancës që do të financohet nga Qeveria Shqiptare është në masën 200 milionë lekë, si zë i veçantë i fondit të akorduar për buxhetin vendor si transfertë e pakushtëzuar sektoriale.

5. Pjesa e bashkëfinancimit nga Qeveria Zvicerane dhe donatorë të tjerë i nënshtrohet skemës së plotë të thesarit, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024, "Për regjistrimin përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare".

6. Kriteret, procedurat dhe treguesit e performancës që do të përdoren për akordimin dhe shpërndarjen e këtij fondi, si dhe të drejtat e donatorëve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për pushtetin vendor.

7. Subjektet përfituese dhe zbatuese të këtij fondi janë bashkitë.

ANEKSI 10

